

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 169, Nëntor 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

2 A DUHET TË NDËRTOHEN APO JO, HIDROCENTRALE MBI LUMIN E SHALËS?!

Një dilemë e vështirë e ngjashme me dyzimin e një vajze bukuroshe me shume kërkesa për fejëse, por që nuk e ka ndarë mendjen as për po as për jo! Sa Hc-e do të ndërtohen mbi Lumin e Shalës, ku janë projektuar, kur dhe nga kush do ndërtohen, është një ekuacion tjetër me disa të pa njohura. Lumi i Shalës apo lumi i Lesniquës, është arteria kryesore e Zembrës së Alpeve tona të bekuara nga Zoti (37 km i gjatë, me rënie mesatare 22 metra në një kilometër, me prurje mesatare vjetore, afro 34 m³/sek). Mbi këtë kaltërosh të kristaltë, flitet e përflitet ndërtimin e disa Hec-ve, por përcaktohet për fatin e këtij lumi është vetëm një, ai që do ndërtohet me dige, ku projekti ka përcaktuar edhe lartësinë e saj.



4 Festa Nacionale e Austrisë

Tani u bë traditë, që çdo vit në Shkodër, nën drejtimin zotit Gjergj Lejzeza, Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë, të mbledhemi në mjediset e Hotel "Rozafa" dhe të festojmë Festën Kombëtare të Austrisë.

Pra, edhe këtë vit, si përhëra, me datën 27 tetor 2017, në mjediset e Hotel "Turizmi" u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë. Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit i Austrisë, zoti Gjergj e zonja Natalja Lejzeza dhe Ambasadori i Austrisë në Tiranë, zoti Johann e zonja Himan Sattler.



8 PROE Dr. VUKSAN KOLA VJEN PARA LEXUESIT MESTUDIMIN "HISTORIA E PSIKIATRISË SË SHQIPËRISË" DITA E PLUSIT, NË KULLËN MUZE TË AZEM BEJTËS, NË GALICË 6

Sot, 28 tetor 2017, ditë e shtune, pati disa veprimtari të rëndësishme kulturore e me interes kushtuar DITËS SË PLUSIT, manifestim që po mbahet për herë të katërt e që u mbajt në Kullën-muze të Azem Bejtës, në Galicë (Vushtrri). Fillimisht, organizatorët e manifestimit bënë homazhe të varrezat e të rënëve në Prekaz. Ky rit ishte mbresëlënëse, që e beri tabloja e homazhit me plisa në kokë për nderim.



A DUHET TË NDËRTOHEN APO JO, HIDROCENTRALE MBI LUMIN E SHALËS?!

Një dilemë e vështirë e ngjashme me dyzimin e një vajze bukuroshe me shume kërkesa për feje, por që nuk e ka ndarë mendjen as për po as për jo!

Sa HC-e do të ndërtohen mbi Lumin e Shalës, ku janë projektuar, kur dhe nga kush do ndërtohen, është një ekuacion tjetër me disa të pa njohura.

Lumi i Shalës apo lumi i Lesniqes, është arteria kryesore e Zembrës së Alpeve tona të bekuara nga Zoti (37 km i gjatë, me rënie mesatare 22 metra në një kilometër, me prurje mesatare vjetore, afro 34 m³/sek). Mbi këtë kaltërosh të kristaltë, flitet e përflitet ndërtimin e disa Hec-ve, por përcaktues për fatin e këtij lumi është vetëm një, ai që do ndërtohet me dige, ku projekti ka përcaktuar edhe lartësinë e saj.

Diga duke u ngritur në rrjedhën e poshtme (poshtë fshatrave Pepsumaj apo Mollë edhe këtu nuk dihet saktësisht piketa) do të thotë se, sektori i poshtëm dhe i mesëm i këtij lumi deri në Breg Lumi Shalë, te shendërrohet në liqe.

NË ASPEKTIN EKOLOGJIK

1-Ndërtimi i HC i tillë, është një revolucion kundër asaj arkitekture solide të krijuar që nga epoka e kuaternarit.

2-Ndërtimi i një HC i tillë do zhduke përfundimisht Troftën pikaloshë, një nga speciet me të xhevahirta të ujarëve tona të ëmbla (e trajtuar babrabarishit për më se 35 vjet pa ndërprerje)

3- Pasoja të menjëhershme do të ketë edhe në klimë. Pellgu i Shalës dhe i Shoshit do të mblodhën në pjesën e lagshtë të vitit nga një mjegull e zyrtë vrasëse, sidomos për kulturat bujqësore në pranverë dhe kërcënuese për mushkëritë e shëndetshme alpine.

4-Pasoja në florë, faunë dhe hidrografi do jenë më të pa dukshme, por të pa evitueshme.

5-Ndërtimi këtij HC do të nxisë sopatat e babëzitura, që mesi presin të përsërisin masakrat e Cukalit, Pukës, Skarpatuesh e kudo ka shkelë goma e tramapilit.

NË ASPEKTIN EKONOMIK

Është një lopë laramne qumështore

pa shpenzuar as gjë për grazhditjen e saj. Kjo pasuri ujorebollshme e ftohtë qindpërqind e pijshme, e shëndetshme si më s'ka;

- A mund të ketë vlera më të çmuara në fusha të tjera, si në ujësjellës, në industrinë fabrikimit të ujit, të rritjes së troftës e të tjera fusha duke mos shkathur as një pasojë eko-mjedisit?



Ne, nuk kemi politika ekonomike aq kualitative dhe largpamëse, për rrjedhojë nuk kemi as projekte racionale të perspektives as oponente as debat publik për resurse të tilla.

Kjo arterie, e virgjër, e egër dhe pa fat ka mbetur shterpë nga pa aftësia jonë shekullore ndërtuese. Tani, që tellalli i vonuar na zgjoi nga gjumi kam frikë se nuk do dimë të ndërtojmë dhe lus Zotin që pas një ndërtimi të mos vijë një shkatërrim më i madh siç ngjet rëndomtë në vendet e botës së tretë.

ÇFARË DO TË PËRFITOJË BASHKËSIA I DUKAGJINIT NGA KY HC.

Së pari, nuk dihet se kush do ta ndërtojë, gjitha gjasat janë se do jetë shoqëri, konçesionare, pasi dihet kivetit i buxheti tonë (vetëm E. Hoxha kishte prapanicë

të bënte investime të tilla mbase nuk vidhej më shumë se ndërtohej). Po të flasim nga pozitë e patriotizmit naiv nusen tonë virgjërshë do gëzojmë me shokë (madje jemi të detyruar tua çojmë në shtrat edhe tu mbajmë edhe pishën).

Por nuk kanë faj as turqit, as kinezet as evropianet kur për gjithçka madhore u ka vdekur ora shqiptareve! Ndonëse në

sore Stupen, pa qene specialist, intuita me thotë se, materialet për këtë digë do vijnë nga Rruga e Komanit- Bregut të Lesniqes apo bregut liqenit nga Temal – Dushmani.

Nga ky project, Shoshit, Shalës dhe Pultit i hyn ujitë nën bythë, ndërsa pa asfalt do mbeten si deri më sot. Nëse ngjet kështu, atëhere të gjitha janë si me të hy hajdutët në shtëpi me të vjedhë, por me të marre edhe gruan. Po të kishte bashkësi si në Zvicër, Austri, e vendet Nordike kjo nuk do mund të ndodhë. Pyetja parashtruese; - A duhet të ndërtohen apo jo hidrocentrale mbi lumin e Shalës?!

Unë them, nëse ka ndonjë projekt për në Theth (qofte edhe pa dige) nuk duhet ndërtuar kurrësi.

Hidrocentrali i projektuar me digë në rrjedhën e poshtme, për të qenë pragmatist dhe jo ambientalist, them se duhet ndërtuar me kusht:

-Pavarësisht kudo që të ndërtohet ky basen, rruga Prekal – Shosh - Breg Lumi duhet asfaltuar. Po ashtu dhe rruga Koman - Bregu Liqenit - dige HC të ri, që lidhe zinxhirin ujore të dy liqeneve.

Duhet pranuar se baseni Hec të ri nuk shkakton përmytje të konsiderueshme pronash, prandaj për leverdinë e madhe ekonomike që parqet, duhet toleruar në disa aspekte mjedisore, pasi kjo vepër gjithë pellgun e Dukagjinit e kthen menjëherë në atraksion turistik.

Nëse nuk ndërtohet kjo infrastrukture, kemi të bëjmë me në akt të madh plaçkitës, gjë që na kujton pasqyrat dhe rruazat kolonizatorëve spanjolle, që u jepnin indianëve në këmbim të arit dhe dimanteve.

Ti japësh shtetit shqiptar apo një koçesionari të zgjedhur nga ky shtet një she me miliona e miliona pa fund dhe minimalisht të mos ndërtohet as një rrugë për banoret dhe vizitordashësit e atyre maleve, është skllavëri dhe prostitucion.

Prele Milani

Retë nukleare po mbulojnë planetin

"E megjithatë asnjë njeri tjetër nuk ishte më modest se Ajnshtajni në posedimin e fuqisë së dijes, e më i sigurt se kjo fuqi është fatale." Duajt Eisenhower.

Njerëz zgjohuni...! Një "Meteor Nuklear", i paparë, është "nisur" ta godas planetin...! Është i fshhtë, dinak, tinzar, jashtëzakonisht shkatrues dhe mizor, vepër e "Djallit", sundimtarit të flakëve përvëluese të Ferrit! Shtëpia e jonë e përbashkët në prag të...!!! Për fat të keq ky fenomen, që i ngjan një vullkani në

shpërthim, ekziston! Bota prej dekadash ndodhet jashtë kontrollit! Retë nukleare po mbulojnë planetin...!

Testi i gjashtë bërthamor i bombës me Hidrogjen H i Koresë së Veriut, me urdhër të udhëheqësit suprem Kim Xhong-U, u krye me sukses. Forca e saj shkatruese llogaritet 1000 herë më e fuqishme se dy bombat atomike amerikane të hedhura mbi qytetët Japoneze, Hiroshima e Nagasati në ditët e fundit të Luftës së Dytë Botërore, të cilat iu moren jetën mizorisht qindra e mijëra njerëzve të pafajshëm.

Ndodhemi si para një "termetit të frikshëm" ku dita agon e qetë, e bukur, plot Diell e shkelqim. Udhëtojmë pa ditur se ku shkojmë?! Një urdhër i gatuar dhe i pjekur me urretje, tërbim, sharje e zemërim mund të shkaktoj një zjarr të përmasave globale...!

Amerikë në zemrën e në shpirtin tënd ndodhet e sotmja dhe e ardhmja e popujve të Botës. Ju jeni shteti më i fuqishëm, megjithatë kujdes, armët bërthamore nuk njohin supërfuqi...! Ato janë me mijëra herë më të rrezikshme e të pamëshirshme se mjaft sëmundje të pashërueshme, të cilat vrasin me miliona njerëz në vit. Angazhimi i forcave dhe i mjeteve ushtarake jo kurdoherë jep rezultatët e kërkuar...! Përkundrazi...! Asnjëherë nuk është vonë për bisedime.qoftë edhe midis armiqve të eger, të betuar dhe të çmendur ndaj njeri tjetrit.



Presidenti Trump: "Një sulm i mundshëm ushtarak nuk mund të përjash-tohet..." Më parë masat diplomatike dhe sanksionet ekonomike të Këshillit të Sigurimit të O.K.B për izolimin e plotë të Koresë së Veriut..." Por ajo është e armatosur me bombën me hidrogjen, e cila mund të shuaj një qytet të tërë, fjala vjen të një supërfuqie, prej disa miliona banorësh...! Kundër-

përgjigja, një sulm frontal i përmasave të pa parashikuara! Pasoja...!" Një popull, një komb e një shtet i shkatërruar ...! Jo vetëm kaq...! Ekstremet nuk njohin kufi...!

GËK-MËK!

Ese...

nga Lazer Kodra

Pyetje: Ku e keni resitur drekën këtë fundjavë o padronët e arsimit të vendit tim?!

Nëse turpi dhe shkatërrimi nuk janë tabu

Një ditë të afërt do bien mbi ju!

Nuk e di nëse ua ka qitë Zot për hise që të keni ndonjë Gëk-Mëk në ndërmarrjen tuaj. Fatëkeqësisht, ndërmarrje është edhe i dikurshmi Arsim. Ndërmarrja jonë e arsimit është vetëm një Gëk-mëk. Çdonjërit dhe çdonjërsë që arrin për të kuptuar injorancën e tejskajshme që ka, dhe fatëkeqësisht në rrafshin universal të shoqërisë sonë mbloçitinin rolin e drejtuesit/ses në në linjen vertikale, ua di shumë për nderë. Të njohësh injorancën e vetëvetes, nuk është pak. Nuk është pak, sepse diktohes prej saj dhe mban qendrim të heshtur... të pakten tregohesh njerëzor! Gjithsesi kjo ndodhë sa për të mbuluar vetëveten. Nuk është çudi! Edhe Struci e ka fshehur kokën në rërë. Edhe injoranti mbijeton me formën e tij. Me formën më vulgare, më idioteske, me formën më të turpshme, më antinjerzore. Jo më kot në zonën timë, në Dukagjin thuhej shprehja: Me të diturin nuk bie kurrë në hall! Ai di të falë. Di të arsyetojë. Di të argumentojë. Di të mëndojë! O Zot na ruaj nga injorantët e injorantet që drejtojnë! Injoranti/tja nuk di as të të falë, nuk e njeh humanizmin, as njerëzoren, as familjen, as konceptet e vlerat universale, as mesazhet bashkëkohore, as anënn ideale, as linjen e katarsisit.../është pjellë e dreqit, nuk di as të argumentojë, as të arsyetojë, i pëlqen dhuna,dehet nga e keqja, entuziazmohet nga krimi, ka dëshirë të mashtrijë, të shpifë, të ngrihet në "maje të shulit të pushtetit", të këndellet në dreka e darka "orgjie" brenda e jashtë kufinjëve të Atdheut të tij (Atdhe që nuk e ka për gjë ta shesë edhe me çmimin e domateve, edhe me çmimin e gjerdhekut zyrtarë, Atdhe që nuk e njeh! Atdheu e mundon si koncept, nuk do t'ia dijë, i drunjëzuar, pa moral, pa ideale, pa koncepte, pa karakter, i/e shkurëzuar nga virtytet, i/e by-



myer nga veset katapultohet në podiumin e delirancës së madheshtisë f a l l s o ! F a s a d ë ! Fasadë!Fasadë! Thjeshtë mban përpara disa shkresurave të ardhura nga hierarkia vertikale (po aq injorante sa ata e ato), i lexon në versionin, tashmë të pranuar nga të gjithë, analfabet funksional dhe trumbeton me vrazhdesinë

e daulles se shpuar: "përkushtim", "arritje", "cilësi", "kurrikulë e shkelqyer"... dhe e gjitha kjo bëhet nën petkun e një injorance të tejskajshme që ka pushtuar shoqërinë tonë, e aq më tepër Ndërmarrjen e Arsimit (dikur... ish Ministria e Arsimit), sot sinonimi e Ministrisë së Punëve Botore të kohës së Ahmet Zogut. Të mendosh është filozofi, madje shumë kohë më parë teoria Karteziane shprehej: Unë mendoj...pra jam! Po këta nuk mendojnë më i dashur lexues! Pa lere pastaj se sa lexojnë! Janë vetëm përfaqësues të "dhëndërrisë politike" ose produkt i kanalit fekalor të rryshfetit monetar. Produkti i tyre duket: 45% e nxënësve të klasave të pesta janë, me statistika shtetërore, "analfabetë funksionalë!". Udhëzime që vijnë në shkollat e mesme për të luftuar analfabetizmin!A është e turpshme kjo? A është e çuditshme kjo? Për ne...po. Për injorantët/tët...jo! Lavdi i qoftë kohës sonë!" kohës së injorantëve", "kohës së m...tit". Çuditëni!!! Po, po "kohës së m...tit". Është ma e lehtë ta bësh se sa ta hashë! A nuk po e hajmë?! Na bëftë mirë mirë! Produkt me destinacion të veçantë! Menu për ne që e gatujmë! Picullakë e picullake, përta i përket nivelit arsimo, drejtojnë sot arsimin e vendit tim! Pa asnjë lloj Begraundi arsimor, shkencor, intelektual, kanë lidhë arsimin me kapistër për ftyi dhe e tërheqin drejt humnerës! Krahasimisht si ata që grumbullojnë hekurishte të vjetra, edhe këta thërrasin:Hajde ndonjë nxënës në shkollën time, sepse pa ju ne nuk mund të mbijetojmë! Më kujtohet, kohë më parë, kur një drejtuese e arsimit shkon në një zonë malore për kontroll. Kur bën apelin e mësuesve të zonës, në vend të emrit të një gruje, që ishte mësuese, ngrihet një

burrë. Atëherë Drejtoresha pyet: Unë thirrja emrin e një gruaje? Zotrote, mësues allasojna shqiptar, përgjigjet: Unë jam i shoqi. Ka një muaj që gruaja ime është e sëmurë dhe kam dalë unë në vend të saj! Drejtuesja rajonale rrudhi supet dhe kerkoi një kafe. Uroj që të mos ndodh kështu edhe sot në vendin tim. Përndryshe lapsi im nuk do të pushojë së shkruari, sado e madhe qoftë kostoja e së vërtetës. Sidoqoftë, kosto ma e madhe se e Xhordano Brunos nuk do të jetë!. Kriteri drejtues i arsimit të sotëm është një formulë aspak me ngjyresën e shekullit, por një formulë sa magjike, sa ndjellakeqe, sa varrmihëse për shoqërinë tonë: PARAPUSHTET-KRISTAL-ARGENT! Sherbimet e zeza, që po i bëni këtij vëndi, nuk do ua falë as Kisha, as Xhamia, as shoqëria, as buzëvarri, madje as bijat e bijtë tuaj, që sapo t'u injektohet vetëdija dhe ndërgjegjia e njeriut të shekullit XXI do u sjellin lule të zeza mbi var! Krahasojeni arsimin e sotëm me datën e Hapjes së Shkollës së Parë Shqipe; Me Kongresin e Manastirit; Me Periudhën e Pavarësisë, Me periudhën e e Revolucionit të Qershorit; Me periudhën e Ahmet Zogut; Me periudhën e Pushtimit Fashist; Me periudhën zhdukjes se analfabetizimi; Me periudhën e Komunizmit...dhe pastaj peshojeni veten tuaj!!! Të falemnderit i ndjeri Fan Noli, për vargjet Tua: Ti Halim/Që s' di këndim/ Bëhu vezir/ P për arsim! Po hajde edhe njëherë në tokën time dhe tënden, o Idhulli im i Letersisë, dhe shikoji Halimët dhe Haleshat që i kanë zënë frymën këtij vëndi, këtij vëndi me shumë aspirata e njëkohësisht me shumë "furra" injorantësh/esh që prodhojnë vetëm gaz karbonik! Vendi im është pa frumëmarrje o mik! Të duket e pabesueshme...!? Jo, është e vërtetë! Ky vend e ka ndarë mendjen: Dëshiron të vdesë me dashje!!! Ata që nuk e lexojnë dhe e kuptojnë mjerimin, meritojnë ta jetojnë atë. Heshija e tyre është shërbesa më e mirë që u bëjnë injorantëve/ve. Madje ata, injorantët/et, luten në Kishë e Xhami që t'ua mbajnë Zoti mendjet të pandryshura skilleverve e skalaveve të tyre. Padronët e "arsimit" tonë dinë të mburren, të paraqesin arritje Aleksandrine, të kopjojnë gjatë vizitave në Evropë modele të pazbatueshme në shoqërinë tonë minorene në raport me Evropën, të zhërvellen e të zhërvallen në mediat e shkruara dhe elektronike, dhe kur vjen puna e rendimentit të të nxënësve fillojnë e belbëzojnë në sinkroni të plotë midis tingujëve të fuqitë janë të mbrojtura e të siguruar nga armët e tyre bërthamore!" Paradoksale dhe fatale! Beteja nukleare nuk do të kursej askënd, as edhe vetë ata! Po fëmijët, nipërit e stërnipërit e tyre ku do ti çojnë? Mos vallë në planetin Mars?! Të gjithë, në një mënyrë apo një tjetër, mos herët vonë, do të jenë pre e saj. Fundi, ç'iu duhet jeta disave, në një "oazë" nëntokësore tej mase të vogël në mes të një shkretire të pafund të djegur shkumb e hi, kur të gjithë të tjerët, qindra miliona njerëz, të jenë larguar mizorisht nga kjo botë?!

O Zot ruaj jetën mbi Tokë! Në gjithë Universin s' ka vend më të mirë se kjo Botë....".

Luigj Temali,
Shkodër 21 Tetor 2017

maces,qenit,qyqes,kukuvajkës, mjelmës, hajvanes, hajvanit: Gëk-Mëk! Gëk-Mëk! E shumta u ndryshojnë vendet këtyre tingujve hiç-thënës, nga Gëk-mëk në Mëk-Gëk! Më kujtohet, kohë më parë, kur i Nderuari, Prof. Tefë Topalli (I kerkoj falje për përmemendjen e emrit) iu drejtua një studenti: Ti more djalë nuk mund të bëhësh kurrë mësues!, ...dhe duke parë ndjeshmërinë e tij (të studentit) iu kthye përsëri: Mos u mërzi! Mund të mos bëhësh mësues, por ama mund të bëhësh drejtues me këto kohra që kanë ardhë! A e patë konkurimin dhe rezultatin! E patë! Sigurishtë e patë, jo vetëm konkurimin, por edhe rezultatin edhe reagimin nga "Padroni"! E pastaj...! Pastaj u desh inisiativa "allakomuniste" nga "bukuroshja e fjetur" për të vënë në monokolonë ushtarët dhe ushtarët e trembur nga "dhuna e bukës", qyqarët dhe qyqaret e depersonalizuar si askush tjetër, fakirët dhe fakirët e dërrmuara psikologjikisht, të punësuar në Ndërmarrjen e Arsimit, për të bërë votimin më idiotesk e më qesharëk të të gjitha kohrave, përfshirë edhe kohën e Babaqemos! Ajo çfarë u mblodh, me shatë, për një javë rresht u justifikua me një veprim sa desperues aq edhe trishtues për vendin tonë, aq edhe legal për njerëzit që e kanë trurin në vendin e duhur. Pa dilni njëherë në Dukagjin, në zont e thella të Pukës, Kukësit, Tropojës, Matit, Dibres, Mirditës dhe shikoni ata fëmijë me ëndrra e dëshperim në sy nga mungesa e arsimit, shikoni ata prindër që vajtojnë fatet e fëmijëve të tyre që "mëngjesin" e jetës së tyre. I vetmi shkrim që dinë të shkrujnë është gdhendja e Kryqave dhe Gjysmëhënave mbi rrafshet e guri të sheshtë! Besojeni, se edhe ata janë Shqiptarë! Madje më të denjë disa shumë-hera se ju. Degjenreimi i arsyes ka derivuar deri në atë pikë, saqë një pikë korrektori në regjistër quhet "skandal!", ndersa një armatë analfabetësh nuk përbën asgjë! Asgjë! Bëj betim "edhe ne Kokën e Zotit" se 70% e drejtuesve të "ndërmarrjes sonë" janë shumë shumë më poshtë nivelit mesatar të tërsisë se kolektivit ku drejtojnë! E ç'pritet prej tyre pastaj, përveç motivit të fabulës Agolliane: Në një shteg të ngushtë mali / Printe gomari, pas vinte kali! Latinët do të shpreheshin :O TEMPORA O MORES! E përkthyer në shqip: O KOHË O MORAL! Tashmë, këto nuk janë në shoqërinë tonë e aq më tepër në këtë ndërmarrje me emër të rrënuar: Arsim! Miqtë e mi, mësuesit e drejtuesit e devotshëm të këtij vëndi ultramjeran, që keni ideale të larta, objektiva të qarta e mundësi të cinguar e të dhunuara dua t'iu përshtes me shprehjen e urtë të Rubinshtajnit: "ikur të rrija një ditë pa mësuar do ta ndieja menjëherë. Po të rrija dy ditë kishit për ta kuptuar edhe ju, kurse po të rrija tri ditë do ta merrnin vesh gjithë spektatotët!", ndersa injorantëve që kancerizojnë arsimin e vendit tim dhe vrasin të ardhem e brezave tanë do u kujtoja një shprehje të Gëtes: "Ata nga të cilët ne mësojmë me të drejtë quhen mësuesit tanë, por jo kushdo që na mëson e meriton këtë emër" Ikni! Ikni!... sepse edhe Shën Pjetri në Mangall do u drejtojë me shkop në drejtim të Ferrit. A e meritoni këtë...? Për Zotin e meritoni! Po! Po! Po!

Zotërinj të nderuar, kujdes sidomos me plagët e vjetra të luftës...! Shërimi i tyre është i gjatë dhe i vështirë. Bllokada ekonomike nuk është zgjidhja më e mirë. Ajo shton në ekstrem varfërinë, urinë, skamjen, mjerimin, urrejtjen, shuarjen e jetëve deri edhe pa lindur dhe afron më shpejt përplasjen, luftën. Bomba me Hidrogjen e Koresë së Veriut është një rrezik i madh. Koha nuk prët! Po disa mijëra bomba atomike e me hidrogjen të supërfuqive, anëtarë ose jo të Këshillit të Sigurimit, a nuk janë edhe ato një rrezik i madh, fatalitet dhe Sphatë e Demokleut mbi kokë të Njerëzimit? Ky armatim kolosal, këto armë të shkatërrimit masiv, mund të zhdukun shumëfish herë jetën e të gjitha gjallesave të planetit tonë.

Nëse më lejohet, e konsideroj të nevojshme të kujtoj në retrospektivë një "fragment" të artikullit tim: Të fshehtat e padukshme të Apokalipsit, botuar në gazetën Telegraf, e mërkurë, 29 shkurt 2012

"Pas Luftës së Ftohët u duk sikur shpëtuan nga katastrofa e një konfrontimi bërthamore. Por, sipas "Reuters' Presidenti amerikan Barak Obama u tha delegacioneve të 47 vendeve në Samitin Bërthamor në Uashington se "është koha për veprime të përqendruara globale për të frenuar humbjen e materialeve nukleare...". Rreziku më i madh, posedimi i armëve strategjike nga shumë shtete, të cilët, edhe njeri prej tyre, mund ta hedhin njerëzimin nën kthetrat mizore të një zjarri supërgjigand atomik. "Supër-

Festa Nacionale e Austrisë

Tani u bë traditë, që çdo vit në Shkodër, nën drejtimin zotit Gjergj Leqjeza, Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë, të mbledhemi në mjediset e Hotel "Rozafa" dhe të festojmë Festen Kombëtare të Austrisë.

Pra, edhe këtë vit, si përhera, me datën 27 tetor 2017, në mjediset e Hotel "Turizmi" u festua Festa Kombëtare e Republikës së Austrisë.

Ceremonia u organizua nga Konsulli i Nderit i Austrisë, zoti Gjergj e zonja Natalja Leqjeza dhe Ambasadori i Austrisë në Tiranë, zoti Johann e zonja Himangi Sattler.

Morën pjesë deputet, përfaqësues të autoriteteve vendore të Bashkisë Shkodër, të Qarkun Shkodër, personalitete në fusha të ndryshme të jetës shoqërore e sociale të bashkisë tonë.

Morën pjesë dhe përfaqësues të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, Luigj Shyti, Syka Çarku e Anton Kosteri.

Pasi, u ekzekutuan Himni i Republikës së Austrisë dhe i Republikës së Shqipërisë, fjalën e rastit e mbajti, Konsulli i Nderit, Gjergj Leqjeza.

Pastaj të pranishmit i përshëndeti Ambasadori i Republikës së Austrisë, në Tiranë, zoti Johann Sattler.

Në fund të përshëndetjeve u dha një koketejl për pjesëmarrësit dhe vijoi festa në grupe-grupe.

FJALA E PLOTË E PËRSHENDETJES I KONSULLIT TË NDERIT TË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, ZOTIT GJERGJ LEQEJZA

Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare,

Të nderuar drejtues të pushtetit vendor,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Shqipërisë,

E nderuara zonja Voltana Ademi, Kryetare e Bashkisë Shkodër,

I nderuar shkëlqesi, Zoti Ambasador,



Të nderuar miq,
Dëshiroj t'ju falënderoj përzemërsisht të gjithëve ju për pjesëmarrjen në Festen Kombëtare të republikës së Austrisë dhe

gjithashtu t'ju falënderoj për mbështetjen tuaj të vijueshme që nga hapja e Konsullatës së Nderit në Shkodër, që në vitin 2004.

Jemi mbledhë këtu për të festuar Festen Kombëtare të republikës së Austrisë, popullit mik Austriak simbol i kulturës, mirëqenies e paqes në Evropë e më gjere, e cila padyshim behet edhe ma e bukur me prezencën tuaj sot ...

Faleminderit !

Java e veprimtarive për festën kombëtare të republikës së Austrisë, është e mbushur plot me vente, të cilat u hapen nga Shkolla Austriake në Shkodër "Peter Mahringer", me një koncert të shkëlqyer artistik, me nxënës të klasave të 8/9 –ta çka tregon për rritjen e konsiderueshme të interesit të familjeve jo vetëm Shkodrane, për të regjistruar fëmijët në këtë shkollë, por sidomos të cilësisë së nxënësve. Vjuan me veprimtari "Austria lexon", me të ftuar botuesin Ilir Thera.

Kjo është fryma që sjell Austria në Shkodër dhe unë jam krenar që të përfaqësoj një komb me kaq shumë dimensione kulture, zhvillimi, dhe humanizmi, dhe jam po aq krenar për lidhjet mes kombeve tona, që po forcohen dita - ditës.

Ju bëj me dije, se fale punës së shkëlqyer e kontributit personal të Ambasadorit Z. Sattler, viti i ardhshëm është vendosur të quhet "Viti i kulturës Austriako - Shqiptare", që do të jete i mbushur me veprimtari të rëndësishme e cilësore, dhe disa nga ato, shume interesante për mendimin tim, do të jene në Shkodër.

Në këto veprimtari kulturore, shkencore, historike, fotografike e të tjera do të pasqyrohen aspekte të historisë që evidentojnë dhe pasqyrojnë lidhjet e hershme e të gjithanshme midis dy shteteve e popujve dhe një tregues konkret i tyre, është dhe pjesëmarrja e përvitshme e juaja, për të cilën edhe një here ju falënderoj në emër të Konsullatës së Nderit, në emër të Ambasadës, dhe timin personal, dhe ju uroj çdo të mirë për ju e familjet tuaja.

Edhe një here gëzuar Festen Kombëtare të republikës së Austrisë!

Faleminderit !

Korespondenti i gazetës "Dukagjini"

MALËSI E MADHE, ME PESË "QYTETARE NDERI", NË NJË DITË

Bashkia Malësi e Madhe ka organizuar pasdreken e kësaj të premtë ceremoninë e dorëzimit të titujve "Qytetarë Nderi" për pesë personalitete kontribuese për Malësinë e Madhe. Ka qënë kryetari i Bashkisë z. Tonin Marinaj, i cili fillimisht në fjalën e tij është ndalur tek vlerat që i përcjellin bashkësisë, këto personalitete që sot janë vlersuar me titullin "Qytetar Nderi".

Col Cufi, i cili edhe pse tashmë është ndarë nga jeta, kujtohet dhe nderohet kudo, dhe nga të gjithë për vlerat e veçanta të treguara gjatë jetës dhe veprimtarisë së tij ...

Po kështu një tjetër personalitet i spikatur, madje i njohur si mjeku Malësor, që ka kontribuar dhe nderuar gjithë Malësinë e Madhe, më punën dhe përkushtimin e

tij ndaj pacienteve në tersi, dhe veçanarisht Malësorv, është fjala për dr. Zymer Kurti.

Nikolla Spathari, gazetari dhe publicist, por njëkohësisht dhe shkrimtari e studiuesi i Malësisë, me stidimin e librin, me titull "Ashtu siç e njoha unë", e ka merituar denjësisht këtë titull. Kampioni kombetar Selaudin Zogu, një nga sportistët elitë të Malësisë së Madhe ndër vite, edhe pse ka marrë mjaftë tituj e vlersime, ky siç shprehet: "Ai është një vlersim i Artë që i bënë vëndëlidnja e Tij".

I pësti, natyrisht i renditur rastësisht nga ne, por jo nga titulli, sepse të gjithë tashmë këta janë "Qytetar Nderi", është një Italian i natyralizuar në Malësor, Pjer Paulo, kontribues prej shumë vitesh në Malësi të Madhe, me fondacionin e tij të

organizates "Viss Albania", ka bërë, jo pak investime në fshatrat e Malësisë së Madhe, dhe siç premtoi Ai, sërish nuk do largohet nga Malësia e Madhe. Kjo veprimtari vlerësuese për këto personalitete ka pasur natyrisht përgëzimet e të gjithë

të pranishmeve, por veçanarisht të kreut të Bashkisë Malësia e Madhe, Tonin Marinaj, të nënprefektes Taze Lohja dhe të autoriteve të tjera të Pushtetit vendor.

Gëzim Vuçaj



MUZIKA SHKODRANE- 2017

ZHVILLOHET NË SHKODËR TAKIMI I PESTË I "MUZIKËS SHKODRANE"

Për "Muzikën Shkodrane" janë bërë me dhjetëra e qindra studime shkencore dhe shkrime publicistike, sepse "Ahengu Shkodran" nuk është thjeshtë një krijimtari dhe manifestim artistik, por një pasuri e madhe që lidhet ngushtësisht me shpirtin shënkullor të një populli, kështu që ai jeton i gjallë bashkë me vetë popullsinë që e ruan dhe trashëgon, duke krijuar kështu traditën.

"Ahengu Shkodran" është tanimë një institucion kulturor që na bën krenar.

Në këtë shkrim nuk do të ndalemi tek vlerat dhe karakteristikat historike e bashkëkohore të "Muzikës Shkodrane", sepse për këto vlera me 29 shtator, Ditën e Trashëgimisë Kulturore nga Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike në mjediset karakteristike të Muzeut historik në Shkodër mbledhi në dhomën e burrave të kësaj shtëpie të vjetër, specialistë të fushës së folklorit, të muzikologjisë dhe të historisë ku pati mjaft diskutime nga të pranishmit, që përmes fjalës së tyre evokuan vlerat e kësaj pasurie kombëtare, por vunë në dukje edhe problematikat që dalin për t'i ruajtur ato deri në ditët tona dhe për t'i transmetuar tek brezat e rinj.

U ulën në këtë tryezë tradicionale dhe shkencore profesorët e shquar Ferid Bala, Zef Çoba, Ridvan Karaçiqi, pedagogu Arben Prendi, si dhe profesor Behar Arllati nga Gjakova, i cili merr pjesë për herë të dytë në këtë manifestim me shumë vlera, të përvitshëm që ruan identitetin e "Muzika Shkodrane" dhe të vetë Shkodrës si qytet me tradita mijëvjeçare, të cilët evokuan emrat e mëdhenj dhe të paharrueshëm të artistëve shkodranë që krijuan këtë vlerë kaq të madhe të pasurisë kombëtare të popullit tonë.

Në këtë takim ra në sy mungesa e shkrimtarit dhe studiuesit të artit dhe kulturës z. Isa Alibali, i cili jo vetëm që ka dhënë një kontribut të shquar në këtë fushë si drejtues për shumë vite në Teatrin "Migjeni", ka krijuar Shoqatën "Dashamirët e Këngës Shkodrane", por në studimet e tij të pafundme do të mjaftonte vetëm Libri "Në Shkodër të gjithë këndojnë", që ai të meritonte respektin e profesorit.

Por këtu unë nuk do të zgjatem, sepse kjo është një temë më vete, por do të merrem më shumë me vetë veprimtarinë artistikë që u zhvillua me këtë rast në Teatrin «Migjeni», në të cilin gjithashtu organizatorët ishin institucionet që kam përmendur më sipër.

"Çfarë është kjo magji, e filloi prezantimin e shfaqjes moderatorja simpatike Gentiana Dani, që mbart me vete kënga popullore shkodrane dhe këtë ju do ta shijoni dhe zbuloni gjatë kësaj mbrëmje".

Kështu iu drejtua ajo spektatorëve dhe kështu ndodhi. Tingujt e magjishëm të

kësaj muzike të mrekullueshme, të këtyre këngëve të papërsëritshme, pushtuan sallën e këtij tempulli në një mënyrë krejt të re e befasese, pasi këtë natë nuk këndonin korifejtë e "Muzikës Shkodrane", por bijtë e bijat, nipërit dhe mbesat e tyre, ai brez i mrekullueshëm, që me talentin e tij i bën këngët e «Muzikës Shkodrane» të pavdekshme, duke treguar se tradita e këngës popullore qytetare shkodrane jeton e gjallë.

Një traditë vdes kur nuk ka kush e trashëgon atë, por është vitale dhe e përjetshme kur trashëgohet brez pas brezi.

Kjo për mendimin tim, por edhe sipas ideve që u hodhën në takimin shkencor është suksesi, e aq më shumë, kur në skenë e sjellin zërat e rinj.

Koncerti ishte i mrekullueshëm, publiku e priti jo vetëm si spektator, por në pjesën më të madhe edhe si një këngëtar

aq i dashur për shkodranët, Agim Molla, që po të shprehemi me një metaforë, është biblioteka dhe fonoteka e repertorit të "Muzikës Shkodrane".

I saktë dhe i pagabueshëm, njohës autodidakt i këtij organizimi artistik që quhet "Muzika Shkodrane" me të gjitha rregullat dhe zbatues rigoroz që, me interpretimet e tij, të befason, jo vetëm në evente familjare e shoqërore, por edhe në një skenë madhështore siç është ajo e Teatrit "Migjeni".

Katërbëdhjetë këngëtarë të rinj interpretuan në këtë natë dhe e ndej si detyrim dhe respekt ndaj tyre t'ua përmend emrat, jo thjesht si stimulim, por sepse e meritojnë një vëmendje të tillë.

Anisa Smajlaj, një vajzë energjike me një zë potent që përshtatet me stilen e ndryshme të këngës. Artemisa Mithi, ngjyra e zërit të saj bëri për vete anëtarët

e jurisë "Gjeniu i vogël". Glerdit Turmetaj, me një zë të ëmbël, pjesëmarrës në Festivalin "Zambaku i Prizrenit", që u organizua pak ditë më parë. Klodiana Vata, vajzë kurajoze, e kemi ndjekur edhe në «Talent Show», guxon të këndojë edhe jare.

Bruna Sata, talentin e ka në traditën e familjes. Klinsman Llazani, tipik këngëtar simpatik, që edhe Shyqyri Alushi me Agim Mollen do t'ia kishin zili. Egzona Salaj, jetën e ndan mes Ulqinit dhe Shkodrës. Kemi fatin që ka studiuar në Shkodër dhe tani vazhdon studimet për kanto në Akademinë e Arteve në Tiranë. Ilsi Ademi, sapo ka rrëmbyer një trofe në Festivalin "Zambaku i Prizrenit" si interpretuesi më i mirë. Riaz Bashi, përveç talentit me vullnet, ai kërkon të arrijë limitet e suksesit me vokalin dhe prezencën e tij. Niki Mjeda, e hijshme në skenë dhe e sukseshme në interpretim. Migena Buci, këndon aq bukur dhe me pasion. Ademir Fresku, ndonëse është një instrumentist pianist, këngën dhe veçanërisht atë popullore e ka pasion. Marjana Begu, jo më kot është fituese, ajo nuk i trembet sfidave dhe guxon të këndojë këngët më të vështira. Xhuljana Pjetraj, fioriturat e zërit të saj janë origjinale dhe këngët e preferuara të saj janë jaret.

Të gjithë këta këngëtarë në interpretimin e tyre të shkëlqyer live, u shoqëruan nga formacioni orkestral, Anton Kafalli, Namik Jahja, Indrit Kodraliu, Dritan Mlika, Myrto Dibra dhe Fatmir Mesi, nën drejtimin e maestro Ilir Zoga.

Një risi në këtë aktivitet të përvitshëm ishte nderimi që iu bë nga organizatorët figurave të shquara të "Muzikës Shkodrane" ndër vite, duke iu akorduar "Mirënjohje" për kontributin e tyre të çmueshëm në krijimtarinë letrare, muzikore e të interpretimit si: Mark Kafalli, violinist, kompozitor, 30 vjet drejtues i orkestrës Profesiniste në Teatrin "Migjeni".

Nazmi Lishi, mjeshtri i fizarmonikës dhe më gjërë, "dinasti" e familjes Lishi që gjeneratë pas gjenerate ka nxjerrë

artistë. Hapat e para të karrierës i hodhi në ish Klubin e Rinisë "Heronjtë e Vigut", ndërkohë që kulmet e karrierës i arriti në skenën e Teatrit "Migjeni", ku drejtoi për shumë vite me radhë orkestrën e këtij teatri dhe që u dallua në fushën e interpretimit dhe orkestrimit të këngës popullore.

Luan Barova, virtuoz në instrumentin e fizarmonikës me të cilën shoqëroi sa e sa këngëtarë kur ishte drejtues në orkestrën e teatrit dhe të shtëpisë së kulturës. Regjistrimet e tija të këngës popullore janë akoma model për shumë muzikantë dhe një pasuri e vyer me vlera kombëtare.

File Gjeshi, këngëtare tipike popullore, ajo mbetet një pasuri e vyer në fonotekën e Radio Shkodrës, sidomos në origjinalitetin e valles së kënduar.

Agim Molla, përfaqësues tipik i "Muzikës Shkodrane", simpatik i lindur, për rreth 40 vite vazhdon të jetë i pranishëm në festat dhe gëzimet familjare, duke kënduar vetëm këngë të "Muzikës Shkodrane".

Grupi "Karaifilat që ka Shkodra", një grup origjinal dhe unikal, i papërsëritshëm në llojin e vet që për më shumë se një dekadë punoi dhe ripunoi këngën popullore qytetare shkodrane, duke e pasuruar atë me elementë të tjera artistike.

Ferid Bala, të cilin të gjithë e thërrasin profesor Feridi. Edhe në këtë moshë të thyer ai nuk ndalet së punuari dhe botuari libra dhe studime që janë me vlerë për këngëtarë, muzikantë dhe interpret. Nga puna e tij si pedagog i kantos kanë dalë me dhjetra këngëtarë. Në studimet e tij të shumta mund të veçojmë librin "Kënga dhe këngëtarët shkodranë", që ai të meritonte titullin e profesorit.

Atë natë një ndër këngëtarët që ka nxjerrë prof. Bala ishte këngëtarja lirike Sabahet Vishnja, me një karrierë të gjatë në Ansamblin e Shtetit, duke interpretuar me finesë dhe mjeshtri këngën popullore shkodrane dhe veçanërisht këngët jare.

Si zakonisht për realizimin me sukses të gjithë këtij aktiviteti duhen falenderuar gjithë organizatorët që nga Ministria e Kulturës, Bashkia Shkodër me të pa lodhurën Brunë Keçi, Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" me udhëheqësin artistik Bardhyl Hysa dhe Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike.

Në këtë koncert ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Kryetarja e Bashkisë znj. Voltana Ademi, Kryetari i Këshillit Bashkiak, Xhemal Bushati, si dhe personalitete të tjera,

Festa pas shfaqjes vazhdoi në ambientet e Bar Restorant Hotel "Tradita" që gjendet në një ndër shtëpitë tradicionale shkodrane, ku dhe u shtrua një darkë, vlerat e së cilës do t'ia shtonin edhe këngët nga repertori i këngës popullore qytetare shkodrane.

Ramazan ÇEKA, Tetor 2017



DITA E PLISIT, NË KULLËN MUZE TË AZEM BEJTËS, NË GALICË

Sot, 28 tetor 2017, ditë e shtune, pati disa veprimtari të rëndësishme kulturore e me interes kushtuar DITËS SË PLISIT, manifestim që po mbahet për herë të katërt e që u mbajt në Kullën-muze të Azem Bejtës, në Galicë (Vushtrri).

Fillimisht, organizatorët e manifestimit bënë homazhe te varrezat e të rënëve në Prekaz. Ky rit ishte mbresëlënëse, qe e beri tabloja e homazhit me plisa në kokë për nderim.

Drejtuesi dhe ideator i këtij manifestimi është aktori, poeti e veprimtari Ismet Krasniqi - Lala (Klinë) dhe shkrimtari e veprimtari Prend Buzhala; kurse Këshillin organizativ e përbëjnë krijues, artistë e njerëz të kulturës nga Klina. Kështu, për herë të parë kjo veprimtari u mbajt më 2014, në hapësirat e Muzeut etnik "Agimi i Gjytetnisë" të shkrimtrimit e krijuesit Gjon Gjergjaj (Krushevë e Vogël, Klinë); i dyti u mbajt në Kullën e Zenel Berishës (Dobërdol, Klinë). Dy veprimtarite e fundit u mbajtën jashtë komunës së Klinës: I treti u mbajt në Kullën etnografike të Junikut, në vitin 2016. Kurse, i katërti u mbajt në Galicë.

Shtirja e kësaj veprimtarie, në mes të tjerave, synon që kjo veprimtari të masivizohet dhe te bëhet ditë Kombëtare për gjithë shqiptarët.

Në të gjitha veprimtarite ka pasur një larmi programi: kumtesa shkencore kushtuar plisit, pika programore, rrëfime anekdotash shqiptare që zakonisht bëhen nëpër dhomat tona, dhe, të gjitha ato përfshihen e publikohen brenda një vëllimi, e që quhet "Dita e plisit" (deri më tash dolën tri vëllime e ku përfshihen edhe reportazhe, fotoalbume, mbresa, poezi, këngë popullore kushtuar plisit, tekste të zgjedhura kushtuar plisit e të tjeraj).

Veprimtaria e katërt u zhvillua me datën 28 tetor 2017, ditë e shtune, në kullën muze të Azem Bejto-Galica. Ne kete veprimtari, ligjeruan: Mehmet Rukiqi, Daut Demaku, Brahim Avdyli, Bedri Tahiri dhe Prend Buzhala.

Manifestimin e drejtoi Ismet Krasniqi - Lala. Mbresëlënëse ishin edhe prezantimet autoktone të anekdotave popullore, nga mjeshtri intelektual i rrëfimit të tyre, Salih Zogani. Në manifestim pati edhe program artistik, me rapsodë nga Shkupi e nga Kosova. Meqenëse paralelisht në Vushtrri po zhvillohej edhe Takimi i poeteshave, ato erdhën me plisa të bardhë në këtë ambient festiv, kurse në emër të tyre, një poezi kushtuar Plisit dhe Galicës, e lexoi krijuesja Remzije Zegolli.

Edhe pjesëmarrësit ishin të zgjedhur, ata erdhën nga të gjitha viset e Kosovës, Shoqata "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, nga Shkupi, Presheva, Shkodra, Tirana dhe nga diaspora.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" mori pjesë për herë të dytë në këtë veprimtari. Me 28 tetor 2015, që u zhvillua në Kullën e Zenel Berishës (Dobërdol, Klinë).



Atëhere ishim pjesëmarrës, Ndue Sanaj, Prele Milani, Zef Lulash Sokoli (me kostumin tradicional karakteristik, që nuk jeton), Lulash Brigja dhe Anton Kosteri. Ndërsa në këtë rast ishim pjesëmarrës, Ndue Sanaj, Prele Milani, Ndue Marashi e Anton Kosteri.

Në këtë veprimtari, në emër të Shoqatës përshendeti anëtar i kryesisë, publicist, poeti e botuesi, Prele Milani.

Ndue Sanaj, në emër të Kryesisë së Shoqatës, përfaqësuesit të familjes së Azem e Shote Galica, zotit Hetem Haliti, ju dorëzua titulli "Medalijoni Mehmet Shpendi", me motivacion: "Për luftën, heroizmin, sakrificën e treguar për mbrotjen e Atdheut, për bashkimin e trojeve Shqipëtare Etnike".

Aktorit, poetit e veprimtarit Ismet Krasniqi - Lala, ju dorëzua titulli "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me motivacion: "Një jetë të tërë në shërbim të kulturës dhe shkollimit, ruajtjes së vlerave kombëtare, përmes bashkpunimit, integritit në kulturë dhe krijimtari poetike".

Gjithashtu, piktorit e veprimtarit Idriz Berisha - Xhixhi, ju dorëzua titulli "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me motivacion: "Idriz Berisha, një jetë të tërë në shërbim të kulturës, ruajtjes së vlerave kombëtare, në veçanti nëpërmjet arteve figurative".

Me mbarimin e veprimtarisë, me të gjithë pjesëmarrësit u bën fotografi.

Pastaj na dërguan në një shtëpi, te Kulla e Shaban Mongjollit, bashkëluftëtari më besnik i Azem Bejtës, Azem Galicës, ku hengrëm dreke. Nipi i tij, qe ka emrin e gjyshit, Shaban Mongjollit, na shtroi drekën. Aty u ulëm shtuar, këmbëkryq, si dikur motit. Bisedat në këtë dhomë ishin të lira, për historinë tonë, për gjendjen aktuale në të dy republikat e të tjera, por të gjitha në një drejtim tejetem, mbi vlerat në shekuj të kombit shqiptare bejne ta ndjeme veten krenar, si edhe të shikojmë më shumë përpara, që të punojmë më shumë, në harmoni gjithëpërfshirëse, për të arrite kombet e qytetëruara, të emancipuara. Ne ishim si midis vëllezërve.

Një poezi për Plisin e Bardhe, me titull "Ky simbol fisi - Plisi", nga Sulejman DËRMAKU:

"Ky simbol fisi / Mbi tonën kokë / Në këtë tokë / As u përkul / As ul / Ndër furtuna qëndroi Golgota motesh sfidoi / Arriti në ditët tona / Do të jetë pjesë jona / Dhe ne do t'ia lëmë fisit / Këtë shkëlqim të plisit / Fesi e shajkaça më kot / U përpoqën çdo mot / Të zhbënin tonin fis Bashkë me të bardhin plis Ndër mote do të rrojë / Furtunat do t'i përballojë / Gjithnjë yni fis / Në kokë me këtë plis / Do të rrojë ky plis / Në tonin fis / Krenar mbi tonën kokë / Në këtë tokë". Ndue Sanaj

PROFESOR KOLË PRELA DHE GJOVALIN LUKA SEDOJNË GJYQIN KUNDËR KRIMINELVETË LUFTËS, ME 30 JANAR 1945

Duke studiuar dosjen hetimore të At' Gegë Lumajt njërit nga figurat më qëndruesetare që mbijetoi si Heraklit dy dënimeve me 40 vite burgim nga diktatura komuniste më rezultoi:

Kjo dosje e bëshme me dy volume me një top liste të zezë prej 16 personash ju dërgua në gjyqin e kriminelëve të luftës të 30 janarit 1945 ku krahas At' Gegë, në bankën e të akuzuarve figuroni:

At' Dionis Makaj, At' Giakomo Gardin S.J., Pater Gjergj Vata, Halil Kazazi kapiten i ushtrisë nga Shkodra (Vëllai i Jup Kazazit), Fadil Preza - tregtar nga Shkodra, Kolë Vjerdha ish Kapiten i Xhandarmerisë nga Shkodra, Nush Gjon Barbullushi ish Kapiten i Xhandarmerisë nga Shkodra, Prengë Dodë Kola nga kataundi Nënshat - Zadrimë, Adem Haxhi Zeka ish Kapiten i Xhandarmerisë nga Shkodra, Luigj Mikeli ish Kolonel i ushtrisë nga Shkodra, Mark Podeli ish N/Toger i Xhandarmerisë nga Oroshi Mirditë, Hajdar Ujkë Alia ish N/Toger i Xhandarmerisë nga Kopliku, Shaqir Meta nga Shkodra, Haki Nush Aqifi ish ushtar nga Shkupi, Ymer Sadiku nga katundi Grishe, Malësi e Madhe¹.

Të gjithë të pandehurit kanë patur avokatet e tyre mbrojtës.

At Gegë Luma është mbrojtur nga Av. Dr. Muzafer Pipa, duke lenë rastin e At Geges për trajtuar më gjerësisht në ndonjë botim të veçantë, do të ndalem tek një fakt i ri që nuk e dija më parë ku rezultoi:

Se edhe i pandehuri Kolë Vjerdha ishte mbrojtur me shume profesionalizëm nga Av Qemal Shehi.

Kolë Vjerdha i biri Baltos dhe Tonines ish Kapiten i Xhandarmerisë, 47 vjeç akuzohej se ka qenë bashkëpunëtorë i qeverisë Kuslinge, se ka marrë pjesë në operacionin e Pezës se kur ka qenë ish

1 AQSHT. Fondi MPB Dosja 2026, fl. 32

Rreth Komandant në Dukagjin e Zv/ Prefekt në Lezhë ka raportuar Kryetarin dhe Sekretarin e Komunës së Dajçit, të cilët propagandonin në favor të Lëvizjes NÇ, si dhe kur ka qenë Rreth Komandat në Shkodër ka treguar aktivitetet për zbulimin e personave të Frontit dhe ka kryer

Gjatë kësaj periudhe të dobishme, puna e Profesor. Kolë Prelës nuk është tronditur as një herë nga i pandehuri.

Edhe vete Prof Kolë Prela jep provën e këtij fakti, kur është degjuar para Gjyqit të Zotërisë tuaj si dëshmitarë. I pandehuri nuk injoronte qëllimin e Prof Kolë

Vjerdha, gjatë shërbimit të tij nuk ka sjellë as një pengim për Lëvizjen, përkundër ai e ka toleruar haptazi dhe ka favorizuar. Vërtetësinë e këtij fakti na dëshmuon edhe Zotërinjtë Prof. Kolë Prela dhe Angjelin Luka².

Furra ishte skuqur mirë dhe Kolë

Vjerdha u dënua me 20 vjet burgim punë të rëndë të detyrueshme. Mirënjohja, fisnikëria, sinqeritet dhe burrëria i shtyri Prof. Kolë Prelën dhe Gjovalin Lukën që para një gjyqi të tmerrshëm për Krime Luftë të dëshmonin të vërtetën dhe vetëm të vërtetën e thënë troç, pa pyetur se do reagoje akuza apo regjimi i ri, për të cilën ishte një shpëtë publike.

Nuk di dot as gjë për fatin më vonshëm të Kolë Vjerdhës, ndërsa fati i Prof Kolë Prelës dhe Gjovalin Lukës dihet dhe nuk ka nevojë për komet.

Për komet ka nevojë mosmirënjohja dhe mos vlerësimi i tyre në këto 27 vjet të vetëshpallura si demokraci.

Nga ana tjetër çështja e publikimit të dosjeve hetimore të gjitha moteve të diktaturës operuar një ore e me pare, madje duhej ishte kryer edhe pa anestezë që kur ndryshoj sistemi.

Shqiptaret duhet të përballen me vetveten të shkuarën dhe të sotmen e tyre. As viktimat, as persekutorët (jo si jo nënvizimi im), as te tretet që kanë dëshmuar nuk janë plotësisht lugë të lara. Secili le të mbajë barrë atë që takon në raport me te vërtetën.

Prele Milani

2 AQSHT. Fondi MPB Dosja 2026, fl. 167



arrestimin e Qemal Krajës, që kërkohej nga autoritetet e Durrësit.

Pa u ndalur në detajet e mbrojtjes në tërësi, më tërhoqi vëmendjen reagimi Av. Qemal Shehi, një shkresë e Komandës së Dukagjinit të paraqitur në proces, te cilën mbrojtësi ligjorë e interpreton si vijon: "Akti final i raportin një fakt të kryer, në cilin vetëm konstatohet se Prof. Kolë Prela, ilegal në krahinë e Dukagjinit u ka dorëzuar partizanëve 40 armë luftë. Në shkresë nuk përmendet as një masë për t'u marrë kundër Profesorit. Dëshiroj të ve dukje se shpërndarja e 40 armëve ishte vetvetiu rezultat i një veprimtarie të dëndur të zhvilluar nga Profesor Kolë Prela për një kohë të gjatë.

Prelës, ai e dinte se Profesori kishte dalë në Dukagjin për një propagandë kundër okupatorit dhe mercenarëve të tij.

Pse i perfaqesuem prej meje nuk ka ndjekë dëshmitarin Prof. Kolë Prela?

Pse ai nuk ka marrë masa për të mbytur që në fillim veprimtarinë e tij. Nga ana tjetër shkresa duhet të shikonte rezultatin që ka prollue. Më sipër konstatoam se shkresa përmban thjeshtësinë e një fakti të kryer dhe nuk shprehë vullnetin e persekutimit kundër Prof Kolë Prelës, as kundra partizanëve të udhëhequr prej tij.

Me ketë dua të them se akti për të cilin flitet nuk ka prodhuar e asnjë efekt në dëmin e elementëve të lëvizjes. Në përfundim të kësaj analize, them se i pandehuri Kolë

SHPELLA E FRASHNIT

Përvoja historike ka bërë që shoqëria njerëzore gjatë zhvillimit të saj në të shumtën e rasteve, ta përsërisë modelin e të jetuarit dhe bashkëpunuarit me mjedisin e vet fiziko - natyror. Bazuar në këto përvoja, historia ka vërtetuar se gjurmët e zhvillimit social i gjejmë të vendosura kudo ku kishte burime jete, si kushti themelore i vazhdimësisë së saj, në bregdet, pranë liqeneve, lumenjve ose pranë burimeve të ujit. Ende dhe sot ruhen dhe

praktikohen këto përvoja jete, pavarësisht zhvillimit të madh industrial të kohës moderne që po jetojmë. Duke ju referuar këtyre fakteve një histori e ngjashme është instalua edhe përrreth bregut të Shpellës së Frashnit, në Bajzë të Kastratit, e cila gjendet në pjesën qëndrore të ultësirës përendimore të kësaj krahine. Historia e kësaj shpelle ishte dhe mbetet një mister, legjenda e së cilës zë fill qysh nga lashtësia e që vijon ende rrjedhën e vet si një objekt jetëdhënës edhe në ditët tona.

Për historinë e Shpellës së Frashnit janë hedhur shumë hipoteza, një pjesë e të cilave përmenden edhe nga autore vizitor, bazuar kryesisht në gojëdhëna apo në relacione të ndryshme. Një gojëdhëne e padëgjuar ishte

edhe ajo e malësore Mri Hasaj, banore prej vitësh në bregun e kësaj shpelle, e cila mban mbi supet e veta rreth një shekull jete.

Ajo në kujtesën e vet ruante ende një gojëdhëne të hershme mbi ketë objekt të cilën e përshkruante me pak fjalë.

Dikur thuhej se krejt kjo fushë ishte pyll i dendur, e katundit që ishin ulur për punët e veta dhe kishin humbur një kalë të qorruam e të plakur, se nuk mundte me ecte. Diku pas një motmoti e kanë gjete atë kalë të shëndetshëm dhe i kanë shkuar mbrapa derisa është ndale me pi ujë të ky puçik, që rridhte si një vrulle e që gjarpëronte në drejtim të liqenit. Aty ka kenë një rrasë guri e rrafshet (elti) n elti forme shpelle, ku uji buronte rreze nj el-

tie frashni, e kalonte bri saj. Me vone thuhej se uji humbi menjëherë, kur një ushtar turk lau shpatën e vet pas betejës me malësoret kastratas. Kështu banoret vendosen te hapin nje krua per tee rigjetur ujin. Thuhej se, uji i kronit te Shpellës se Frashnit ishte shume i shëndetshëm dhe i bekuam sa me shëndoshe shume sëmundje, thotë ajo. Shtimi i popullsisë dhe thatësira e mëdha bane qe gjate stinës se verës, uji i kronit te vjetër te shteroje e kjo gjë e shtyni Ndue Pulin nga Culajt te hapte një krua te ri për nahirade (pershpirtshmeri) pasi nuk kishte fëmijë e donte te linte një vepër te mire për banoret e Kastratit. Ky krua vijon edhe sot te jeteburim i jetës se gjalle për banoret.

Rita Shkurtaj

PROF. DR. VUKSAN KOLA VJEN PARA LEXUESIT MË STUDIMIN “HISTORIA E PSIKIATRISË SË SHQIPËRISË”

(Ky artikull është botuar në gazetën “Dukagjini”, nr. 157, ribotohet i përpunuar)

Sa herë marrim në dorë një libër të ri, të shkruar nga kushdo, është shumë kënaqësi, por kënaqësia shtohet edhe më shumë kur autorin e ke të njohur, të afërm, shok apo mik.

Kohët e fundit është botuar dhe vënë në qarkullim libri më i ri i Prof. Dr. Vuksan Kola, “Historia e Psikiatrisë së Shqipërisë”.

Prof. Vuksan Kola lindi në fisin Dragaj të Lekajve të Shalës në një familje me cilësitë më të mira tradicionale dhe bashkëkohore. Që mbas përfundimit të arsimit fillor në vendlindje, mori rrugën e arsimit në qytetin e Shkodrës, ku mbaroi 8 vjeçare në shkollën “11 Janari”, dhe më pas vazhdoi shkollën e mesme në gjimnazin “29 Nëntori”, të cilin e përfundoi në vitin 1975 me rezultate shumë të larta. Sipas rregullave të kohës, shkon në stazh, siç quhej atëherë, një vit si punëtor laborator në Hidrocentralin e Fierzës, prej nga bëri të gjitha përpjekjet për të vazhduar arsimin e lartë. Pati edhe pengesa të shumta, por gjithsesi me punën e tij arriti të fitonte të drejtën e studimit në Universitetin e Tiranës, dega Mjekësi e përgjithshme. Përkushtimi i tij i veçantë e bëri një nga studentët më të mire të fakultetit. Me mbarimin e universitetit në vitin 1982, emërohet direkt pedagog i Katedrës së Neuropsikiatrisë, pranë Klinikës së Psikiatrisë, Qendra Spitalore Universitare, sot “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe që prej asaj kohe vazhdon të kryej punën e pedagogut të lëndës së Psikiatrisë.

Duke punuar e studiuar vazhdimisht, Prof. V. Kola erdhi gjithnjë duke rritur nivelin e kualifikimit të tij pedagogjik, profesional dhe shkencor. Kështu, në vitin 1991 mori gradën “Kandidat i shkencave”, e cila u konvertua në “Doktor i Shkencave” në 1993-shin, kurse me 25 nëntor të vitit 2004, mbrojti titullin “Profesor i Asociuar”. Mbas një pune relativisht të gjatë dhe veprimtarie intensive klinike dhe shkencore, me 10 shkurt 2016, mori titullin akademik “Profesor”.

Profesor Kola ka referuar dhe publikuar një numër të madh artikujsh shkencorë, brenda e jashtë vendit, ka botuar e ribotuar shtatë libra e monografi të sferës profesionale, midis të cilëve edhe një përthim mbi psikiatrinë bashkëkohore nga gjuha angleze. “Historia e Psikiatrisë së Shqipërisë” që vjen tani përpara lexuesve është unik në fushën e vet për nga shtrirja në kohë, përmasat dhe shumëllojshmëria e problemeve që trajton.

Shkrimi me saktësinë e duhur i “Historisë së Psikiatrisë së Shqipërisë” ishte një ndërmarrje e vështirë për Prof. V. Kolën, por edhe një detyrim e përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe. Gjatë të gjithë kohës së punës mbi të, asnjëri prej këtyre

komponentëve nuk i ka munguar për asnjë çast. Midis përkushtimit dhe vështirësive, kjo ishte hera e parë që përshkruhej historia e Psikiatrisë shqiptare, në këto përmasa dhe me këtë shtrirje në kohë. Puna e bërë nga autori është një bazë e



fortë për brezat që do të vijnë më pas dhe që patjetër do të përmirësojnë evidentimin e ngjarjeve të saj. Ata do të kenë një lehtësi shumë të madhe, sepse nuk do të kenë përpara një fushë të pashkelur apo një tokë djerr, por një truall të gërmuar me shumë kujdes, veçse jo në mënyrë të përsosur. Prof. V. Kola thekson me force “se ishte domosdoshmëri fiksimi në letër i të vërtetave historike të kësaj fushe të vështirë të mjekësisë, sidomos në ditët e sotme kur, fatkeqësisht, herë pas here janë shfaqur prirje për të harruar, errësuar apo mbivlerësuar disa nga ngjarjet dhe aktorët e saj më kryesorë. Por historia vetëm mund të rishkruhet, ajo nuk mund të ribëhet asnjëherë”.

Në faqet e librit, të vënë në dispozicion të lexuesve nga autori, gjejmë të dhëna që i kanë rrënjët thellë në histori. Ato i përkasin jo vetëm zhvillimi të psikiatrisë në vendin tonë, por edhe asaj botërore. Kujdes i veçantë është treguar për kërkimin, zbulimin dhe publikimin e të dhënave nga të gjitha periudhat e zhvillimit të shërbimeve psikiatrike në Shqipëri. Mungesa e gjatë e kësaj dege të mjekësisë apo edhe e degëve të tjera të saj gjatë pushtimeve të gjata e të ashpra nga të huajt, duke filluar me pushtimin turk, por edhe zhvillimi tepër i ngadaltë në të mëvonshmet, krijojnë vështirësi për evidentimin dhe vlerësimin e të dhënave, dokumenteve e fakteve të ndryshme his-

torike. Autori bën një analizë të thellë dhe të kujdesshme të përparimit të mjekësisë tone dhe veçanërisht të asaj dege që merret me shëndetin mendor. Hapja e spitalit të parë në shërbim të të sëmurëve psikikë, në vitin 1921 në Vlorë, shënoi një kthesë shumë të rëndësishme në trajtimin e tyre. Dhe pikërisht këtu fillon historia e mirëfilltë e psikiatrisë shqiptare.

Autori përshkruan me hollësi fillimet e publikimit të studimeve dhe te të dhënave mbi shkencën e Psikiatrisë që nis në vitin 1959, kur, në vëllimin e parë “Punime të Psikonevrologëve”, publikohen artikuj të disa prej mjekëve neuropsikiatër të atyre viteve. Më pas, në vitin 1962, Prof. Fejzi Hoxha botoi librin “Njoftime historike mbi zhvillimin e Mjekësisë në Shqipëri”, në të cilin zë vend edhe një historik i shkurtër i psikiatrisë. Shkrimet dhe referatet e mëvonshme, vëren autori i këtij punimi, u përkasin kryesisht dy profesorëve të psikiatrisë tonë, Prof. Xhavit Gjatës e Prof. Ulvi Vehbiut, por të gjitha pasqyrojnë vetëm periudhën përpara vitit 1985. Shkrimet e mëvonshme historike janë të rralla dhe analizojnë probleme të veçanta të zhvillimit të psikiatrisë. Prof. V. Kola, në vitin 2013, përshkruan për herë të parë, por në mënyrë shumë të shkurtuar, ngjarjet më të rëndësishme të historisë së Psikiatrisë së Shqipërisë deri në 31 gusht 2013.

Mendimi për shkrimin e plotë të historikut të psikiatrisë së Shqipërisë kishte disa vite që ishte ideuar nga Prof. Kola. Ai mendonte se ishte në interes të të gjithëve, në radhë të parë të studentëve të mjekësisë, por edhe të profesionistëve të shumtë të shëndetit mendor, të njëjhej e gjithë rruga e zhvillimit të psikiatrisë tonë. Kjo u bë më e domosdoshme kur personalitetet më të mëdha të psikiatrisë shqiptare kishin filluar të largoheshin njëri pas tjetrit nga kjo botë dhe po bëhej gjithnjë e më e vështirë kryerja e kësaj detyre. Nxitje për autorin ishte edhe tendenca e shtrembërimit të historisë së psikiatrisë dhe të kontributeve të personaliteteve kryesore të saj.

Metoda e ndjekur nga autori ka qenë mbledhja e sa më shumë e materialeve historike nga burime të ndryshme, edhe duke takuar shumë mjekë të fushës së psikiatrisë dhe të dhënat e grumbulluara prej tyre, gjithnjë të depozituara në formën e dorëshkrimeve, ai i ka shfrytëzuar si burime bibliografike. Gjithashtu, autori i është drejtuar edhe burimeve elektronike, por në mënyrë të kursyer. Materialin e mbledhur Prof. V. Kola e ka analizuar me shumë kujdes, duke bërë krahasime e ballafaqime të hollësishme. Si bazë në këtë botim ai ka pasur gjithë veprimtarinë pedagogjike, klinike, shkencore e botuese

të Katedrës së Neuropsikiatrisë dhe drejtuesve të saj, e cila ishte krijuar në Tiranë në vitin 1952. Gjithashtu, me zhvillimin e psikiatrisë lidhej pazgjidhshmërisht edhe veprimtaria e gjithanshme e Shërbimit të Psikiatrisë së QSUT-së “Nënë Tereza”, mbasi aty kanë zhvilluar aktivitetin e tyre klinik, pedagogjik e shkencor personalitetet më të shquara të saj. Ky institucion ka qenë gjithnjë qendra e zhvillimit dhe orientimit të strukturave psikiatrike në të gjithë Shqipërinë. Autori vlerëson edhe punën e bërë nga spitalet psikiatrike të rretheve. Por, përveç spitaleve dhe shërbimeve neuropsikiatrike në të gjitha qytetet, në historinë e psikiatrisë janë përfshirë edhe strukturat psikiatrike të organizuara nëpër institucione të tjera shtetërore, si edhe shërbimet psikiatrike private ose të krijuara e të mbështetura nga fondacione të huaja që zhvillonin veprimtarinë e tyre në vendin tonë.

Sigurisht që shkrimi për herë të parë i historisë së psikiatrisë tonë, edhe pse në përmasa të tilla, nuk mund të përfshinte të tërë njerëzit e angazhuar në strukturat e saj dhe të gjitha çështjet që lidheshin me të. Prandaj autori e ka vlerësuar të arsyeshme të shkruhej për mjekë psikiatër, neuropsikiatër dhe psikopediatër me grada ose tituj shkencorë, dekanë fakulteti, pedagogë të brendshëm e të jashtëm të lëndës së Psikiatrisë, drejtorë spitali ose shefa shërbimi e reparti psikiatrik. Në studimin e tij, Profesor Kola ka përfshirë edhe mjekë që kanë marrë vlerësim të ndryshme nga organe shtetërore ose organizma të tjerë kombëtarë apo ndërkombëtare, si shpallja “Qytetar nderi” ose përfshirja në “100 mjekët më të mirë të botës” etj.

Përshkrimi i historisë së psikiatrisë së Shqipërisë në këtë libër realizohet përgjithësisht në formë ditari, ku regjistrohet çdo veprimtari e ngjarje e rëndësishme. Në disa raste analizohen ngjarje të veçanta, sidomos ato të mbas viteve 1990, duke evidentuar edhe mendimin personal të autorit ndaj tyre.

Prof. V. Kola, studimin e tij mbi historinë, e ka ndarë në katër periudha të ndryshme: në periudhën e kishave e të manastireve, në periudhën tranzitore, në periudhën shkencore dhe në periudhën e mbas viteve 1990, e cila është në të vërtetë vazhdim i periudhës paraardhëse, por me specifika krejt të veçanta që lidhen me zhvillimet demokratike në Shqipëri dhe me hapjen e vendit me botën. Për herë të parë në këtë libër përfshihet e gjithë historia e psikiatrisë së Shqipërisë, prej fillimeve të para të saj deri me 31 dhjetor të viti 2014.

Një vëmendje e veçantë në librin “Historia e Psikiatrisë së Shqipërisë” i është kushtuar evidentimit të veprimtarisë së personaliteteve më të

DOM PAVLIN PREKA, MESHTARI RI DUKAGJINAS

Dukagjini i ka dhënë atdheut shumë personalitete në fusha të ndryshme të jetës si në letërsi e art, ushtri, arsim, shëndetësi, ekonomi dhe ka marrë pjesë aktivisht në evenimentet më të rëndësishme historike që vendi jonë ka kaluar. Prandaj ka marrë urdhrin "Nderi i Kombit". Është dalluar nga zonat e tjera për ruajtjen e identitetit të tij, ku bij të tij kanë dhënë edhe jetën për të mos lejuar tjetërsimin. Ka pasur më shumë se çdo zone tjetër edhe klerikë të shquar, të cilët një pjesë kanë dhënë kontribut edhe në fushën e letrave si: Bernardin Palaj, Luigj Marlekaj, Danjel Gjeçaj, Prekë Ndreveshaj, Ambroz Martini apo meshtarët e mëvonshëm si: Gjovalin Sukaj, Kolë Zef Kola e së fundi DOM PAVLIN PREKA për të cilin do të flasim më gjërë. Nga 38 martirët e lumnuem si shërbëtor të Hyjit 8 janë dukagjinas, të cilët u martirizuan për fe e Atdhe, që edhe jane dekoruar me urdhrin "Flamuri Kombetar".



Fshati Nënnavriq, duke qënë shumë arsimdashës, ka pas dhe ka shumë bij e bija të arsimuar në të gjitha disiplinat duke qënë në pararojë të të gjitha fshatrave të Dukagjinit. Megjithatë shumë besimtar, klerik nuk pati. Por fati e deshi që edhe ne tani të kemi të tillë siç është Dom Pavlin Preka.

Dom Pavlin Preka, u lind në fshatin Nënnavriq me 25 mars 1986. Mësimet e para i mori në vendlindje, ku shquhej për inteligjencë e sjellje shembullore duke mos pasur asnjë ves, i cili bëri që të gjithë të flasin veç fjalë të mira për Të. U lind nga dy prind, i ndjeri Mirash Zefi e Lulë Mhillja, fjalëpakë e punë shumë të gjithë paraardhësit e tij, të trunqut të Deli Prekës, janë shquar si njerëz punëtorë, të pafjalë, shumë bujar, jokonfliktual, por kanë shikuar punën e tyre duke qënë edhe shumë besimtar të gjitha këto kanë bërë që të jenë një ndër familjet më të nderuara të Nënnavriqit.

Me lëvizjet demografike, edhe familja e Pavlini u largua nga vendlindja dhe u vendos në Bardhaj për një jetë më të mirë e më afër qytetërimit. Duke e pasur edhe në gen besimin në Zot, Pavlini që në rini ka pas ëndërr që të ngjitet në hijerarkinë fetare. Ishte shumë

aktiv në të gjitha veprimtaritë që kisha bënte, i cili bënte diferencën në krahasim me bashkmoshtarët e tij. "Përveç dashurisë për Zotin, më ka prekë dhe impresionuar figura e meshtarit. Më ngjalli dëshirën për të qënë dikushi për të tjerët dhe mu nxit besimi se do të jem

diçka për të tjerët. Shtysën e parë ma ka dhënë Patër Siro, i cili ka shërbyer disa vite në Shalë. Ai më psikologjisi se mund të bëhem i devotshëm në besimin tim", - Shprehet Pavlini. Nga moshë 16 - 19 vjeç e ka udhëhequr frymëzimi i Patër Xhuzep Guleio-ma. Ky ja nguliti më tepër besimin në Zot dhe dëshirën për shërbimin kishtar. Pas një viti seminarist në Shkodër, Atij ju dha e drejta për të studiuar në Romë filozofi e

teologji, ku qëndroi 11 vjet larg Shqipërisë e familjes si dhe 2 vjet eksperiencë praktike në Mozambik. Duke qënë shumë studiues dhe i vendosur për të shtuar dijet e tij, pas një kohe shumë të gjatë studimore, u diplomoe për filozofi e teologji, duke bindur eprrorët se tashmë Pavlini i plotëson të gjitha kushtet për të qënë një meshtar i devotshëm në shërbim të kishës e bashkësisë. Dhe më në fund erdhi ai moment fatlum, që me 21 tetor 2017 në Katedralen e Shën Shtjefnit u shgurue si meshtar, që nga ai moment do të thirret DOM PAVLIN PREKA. Ishte një moment prekës, shumë solemn e madhështor, sepse kisha shquhet për organizime deri në përfekcion. Meshën e drejtoi monsinior Angelo Massafra. Katedralja ishte mbushur plot e përplot si asnjëherë tjetër, ku shumë njerëz mbetën në këmbë. Arqipezvi Massafra tha: "Pavlini i vogël, por e mbushi plot Katedralen". Pjesmarrësit ishin pothuajse të gjithë dukagjinas nga qyteti, rrethinat, madje edhe ul nga Dukagjini në Shkodër enkas për këto evenimente, të afërm e shokë të Pavlini. Në këtë meshë morën pjesë klerik jo vetëm nga dioqeza Shkodër - Pult, por edhe nga të gjitha dioqezat shqiptare. Pati shumë pjesmarrës edhe nga Vatikani. Meshën shguruese të DOM PAVLIN PREKËS e nderoj me pjesmarrjen e tij Patër Pierr, këshilltar i përgjithshëm i Kongregatës orione e themeluar nga Shën Luigji Orione, provinciali Aurielo Fuzi, përgjegjës për priftërinjtë

e provincës Italiane si dhe shumë klerik nga Brazili, Venezuela, Afrika, Romanja dhe Italia. Na impresionuan fjalët e mira që u thanë për Pavlinin jo vetëm nga ata të dioqezës Shkodër - Pult me në krye Arqipezvin, por në mënyrë të veçantë nga ata të ardhur nga Italia, të cilin e kishin njohur nga afër gjatë periudhës 11 vjeçare të qëndrimit në Romë, i cili me punën, përkushtimin dhe sjelljen e tij atje, kishte fituar respektin e të gjithëve. Momenti kulmor dhe shumë prekës ishte ai i shugurimit meshtarak nëpërmjet shtrirjes së duarve dhe lutjeve shguruese të Monsinior Angelo Massafra. Moment mallëngjyes, por edhe emocionues për të prënishmit, të cilët këtë event e shoqëruan me duartrokite të fuqishme ndoshta jashtë rregullave të kishës. Pavlini veshi petkun e meshtarit, i cili që nga ai çast ka të drejtë t'i çojë vetë meshët dhe të predikojë si çdo klerik tjetër.

Në kuadër të shugurimit si meshtar DOM PAVLIN PREKA meshën e parë e çoi të nesërmen me datë 22 tetor në kishën e "Zojës Rruzare" në Bardhaj. Edhe këtu e njëjta atmosferë si në Katedrale. Pjesmarrës ende më e madhe, sepse këtu banon edhe familja e tij. Të krijohej përshtypja se nuk ka mbetë njeri pa ardhë nga fshatrat Bardhaj e Bleran, por edhe nga Shkodra, që pjesa më e madhe e pjesmarrësve ishin dukagjinas. Aq shumë ishin pjesmarrës sa pjesa më e madhe qëndruan në këmbë, madje edhe në oborr duke mos e ndier lodhjen. Edhe në këtë meshë morën pjesë të gjithë klerikët pjesmarrës në ditën e shugurimit, përveç Arqipezhit. Të gjithë ata që e morën fjalën i thurën shumë komplimente Pavlini, duke shpreh optimizmin për ecurinë e tij. Në predikimin e tij DOM PAVLINI të krijonte përshtypjen se kemi të bëjmë me një meshtar me shumë eksperiencë. Me oratorinë e tij, për t'u pasur zili e me një gjuhë të pastër, e bëri auditorin për vete ku shumë fjalë të tij shoqëroheshin me duartrokite, entuziazëm i papërsëritur më parë. Në fund ju erdhi radha falënderimeve. Meshtari i ri tha: "Në radhë të parë falënderoj Zotin, që ma dha këtë mundësi për të ecur në këtë rrugë që kam zgjedhë dhe të bëhem dikushi për t'i shërbyer bashkësisë. Jam shumë i emocionuar dhe i nderuar që jam para gjithë këtyre besimtarëve nga vendlindja dhe vendbanimi im e shumë më gjërë. Falënderoj të gjithë ata që më kultivuan dëshirën për të zgjedhë këtë rrugë

që më solli deri këtu. (I përmend të gjithë me emër). Falënderim të veçantë kam për shokët e mij të fëmirisë, të cilët mu gjendën gjithmonë pranë. Dhe qershia mbi tortë, falënderoj mbi të gjithë familjen time, ku babai nuk jeton më, të cilët jo vetëm nuk më penguan në rrugën që zgjedha, por përkundrazi më përkrahën e më ndihmuan që kjo rrugë të jetë e pakthim dhe e suksesshme. Falënderoj të gjithë pjesmarrësit e sotëm e të djeshëm, të cilët më shtojnë forcat e më rrisin përkushtimin që të ju rri gjithmonë pranë." - e përfundon ligjërimin meshtari i ri.

Veprimtaritë nuk mbaruan këtu, sepse DOM PAVLINI dhe familja Preka shtruan një drekë për të gjithë të ardhurit nga larg si dhe shokë e miq të PAVLINIT dhe familjes Preka në bar -restorant "Rinia" në Bardhaj. Në fjalën e hapjes meshtar PAVLINI tha se nuk është dasëm pa nuse, sepse unë jam "martuar" me kishën. Aty u krijua një atmosferë elektrizuese. Nëpërmjet muzikës së dixhejt Gjovalini dominuan valet popullore që u drejtuan nga DOM PAVLINI tamam si një valltar profesionist. Në to morën pjesë edhe pjesa më e madhe e klerikëve sidomos ata të huaj, duke u çliruar nga petku i klerikut, të cilët vlerësuan dhe interpretuan folklorin tonë të bukur. Gjallëri drekës i dha rapsodi Gjovalin Shani me këngët për Shalën, Shoshin dhe Shën Terezën si dhe rapsodi tjetër Ndue Shytani, i cili improvizoi një krijim të çastit për Pavlinin, familjen e vendlindjen, të cilin e recitoi duke i dhënë edhe nota humorit. DOM PAVLINI, disa ditë para largimit nga Shqipëria, dha dy meshë në zonën e Shalës, në Thethë e Breglumi, i cili u prit shumë mire, me një pjesëmarrje të paparë, duke u krijuar bindja se nuk kishte mbetë njeri pa ardhur nga ata që janë banorë të përhershëm apo të përkohshëm atje.

Duke e pyetur për të ardhmen e tij Ai thotë: "Për 3 vjet jam emëruar përgjegjës i një qëndre në Romë. Jam i gatshëm të shërbej ku të donë e kudo në Botë, që e kërkon interesi kishtar dhe kërkohet ndihma ime. Do të kisha dëshirë të shërbeja në vendin tim". Jemi shumë optimist se ky meshtar i ri, duke pas parasysh përkushtimin, vullnetin dhe vitalitetin e tij, do t'u ngjitet shkallëve të hierarkisë kishtarë me shumë sukses.

I urojmë punë të mbarë këtij biri të Nënnavriqit dhe Dukagjinit!

Përgatiti Prele SHYTANI

shquara të saj, të cilët gjatë gati një shekulli pune e përpjekjesh të vazhdueshme për të ecur përpara, kanë lënë gjurmë të thella në zhvillimin e kësaj shkence. Veprimtaria tyre e gjithanshme është arkivuar në memorien e mjekësisë shqiptare. Kujdes ka treguar autori për evidentimin në mënyrë më të zgjeruar të dhënave për disa mjekë, si Doc. Hiqmet Dibra, Dr. Mit Vokopola, Spiro Çipi etj., duke i vlerësuar si persona të rëndësishëm të psikiatrisë sonë, por, për arsye të ndryshme e të pashpjeguara, janë lënë disi në hije ose nuk u është dhënë vendi i merituar.

Nga fundi i librit botohet për herë të parë lista emërore e të gjithë mjekëve psikiatër, neuropsikiatër dhe psikopediatër që kanë punuar në Shqipëri qysh nga fillimet e para të shërbimeve. Më pas ekspozohen fotografitë e pesë personaliteteve më të rëndësishëm të psikiatrisë shqiptare që nuk jetojnë më, në shenjë respekti e mirënjohjeje të pakufishme për kontributin e tyre të madh në zhvillimin

e psikiatrisë tonë. Gjithashtu, në pjesën e literaturës, janë evidentuar të gjitha burimet e të dhënave, ku është mbështetur shkrimi i historisë së psikiatrisë. Autori ka shfrytëzuar 50 burime të ndryshme, por ka bashkëpunuar ngushtë dhe ka shfrytëzuar me shumë vëmendje të dhënat dhe mendimet e një sërë kolegësh nga institucionet psikiatrike të ndryshme të vendit.

Libri mbyllet me treguesin alfabetik për termat, emrat dhe strukturat e ndryshme psikiatrike, të përdorur gjatë punës për hartimin e tij, i cili u shërben lexuesve për t'u orientuar me shumë lehtësi në kërkim të gjithçkaje që u intereson në faqet e ndryshme të këtij historiku.

E di mire - shkruan autori - se shkrimi i "Historisë të Psikiatrisë së Shqipërisë" i mbetet borxh shumë kontributit të madh të gardës së personelit infiermier, kujdestar e sanitar të spitaleve psikiatrike në Tiranë, Vlorë, Elbasan e Shkodër dhe në shërbimet psikiatrike ambulatorie të gjitha rrethëve të tjera të vendit, të cilët me vite të tëra punuan me përkushtim të madh

ndaj të sëmurëve mendorë. Profesor Kola mendon se përmasat e këtij libri nuk mjaftojnë të evidentohet edhe veprimtaria e tyre e çmuar, por sigurisht ata kanë qënë e vazhdojnë të mbeten ndihmësit e bashkëpunëtorët më të ngushtë të mjekëve, psikologëve e punonjësve socialë. Pa punën e tyre të palodhur nuk mund t'i dilej mbanë me sukses trajtimin të pacientëve të shumtë.

Prof. V. Kola tregon shumë mirënjohje dhe respekt, por dhe falënderon publikisht Dr. Irma Bekteshin dhe Dr. Valbona Alikajn që i kanë vënë me dashamirësi në dispozicionin konsulencën e tyre për probleme të ndryshme në interes të punës së tij studimore, për gatishmërinë e treguar për t'i ofruar të dhënat e tyre, të cilat hidhnin dritë mbi informacione të pa qartësuar mirë rreth personaliteteve dhe problemeve të rëndësishme të psikiatrisë shqiptare. Po kështu falënderon në mënyrë të veçantë Prof. Bardhyl Çipin, Dr. Dragush Totozanin, Ora Pelinkun, Dr. Miltiadh Veveçkën, Prof. Mentor

Petrelën, Diana Ndroqin, Alma Alibalin, Laureta Selimajn, Dr. Anita Pilikën, Nikolin Lacajn, Elida Cangonjin, Ermira Shkupin, Sokol Preçin, Dr. Voltisa Gjergjin, Dr. Pasho Makutin, Izet Çullin, Ruzhdi Çelën, Avni Lamën e të tjerë. Autori çmon shumë edhe punën e mire që ka bërë mjeku psikiatër, Sadik Lala, në përpunimin me shumë kujdes dhe profesionalizëm të fotografive të botuara në këtë libër.

Së fundi, Profesor Kola falënderon përzemërsisht Zj. Suzana Vehbiu, që e ka pritur me shumë dashamirësi në shtëpinë e saj dhe i ka vënë në dispozicion të gjitha materialet që duheshin për të evidentuar veprimtarinë e gjithanshme të bashkëshortit të saj, Prof. Dr. U. Vehbiu.

Studime e botime të tilla meritojnë vëmendje, publikim dhe përhapje sa më të madhe, sepse i shërbejnë historisë, shkencës, kulturës dhe zhvillimit.

Luigj SHYTI

KOLË FUNIÇI, ASHTU SIÇ ISHTE

Libri "Kujtime dhe mendime në vite" me autor Kole Funiçin vjen para lexuesit me dëshirën e mirë, për të treguar rrugën e tij dhe familjes së tij, jo të lehtë, për shumë vite, por që edhe shumë persona dhe familje dukagjinase e më gjerë do ta gjejnë veten aty. Unë e kam njohur zotin Kole që në vitin 1958 dhe që nga kjo kohë nuk jemi shkëputur. Atëherë isha nxënës në klasën e tretë të shkollës fillore në fshatin tim, Theth. Në këtë vit erdhi në këtë klasë mësues Kola. Ruaj kujtime shumë të mira për mësimin, aq sa mund të kujtoj si fëmijë që isha, dhe marrëdhëniet e mija me mësues Kolën. Nxënësit e kohës time ndjenim kënaqësi kur kishim mundësi të kishim disa relata me mësuesin. Këtë Kola na e mundësoj vetë, me kujdesin që tregonte për ne. Më vonë me ka takuar ta takoj për punë personale dhe familjare kur punonte në këshillin e lokalitetit, dhe me kalimin e kohës më ka takuar ta kem drejtor gjatë punës në shkollën Breglumi dhe në Theth, pastaj edhe kolegj duke qenë drejtor paralel në shkollën e ndryshme, e të tjera. I përmenda të gjitha këto se me zotin Kolë kemi një jetë që njihemi, punojmë bashkë dhe kemi pasur dhe kemi një shoqëri të sinqertë, të mirë dhe të qëndrueshme, e kështu do të jenë vazhdimisht, sepse nuk kemi arsye ndarje.

Më kërkoj që të jepja mendimin tim në lidhje me botimin e këtyre kujtimeve të tij. Përgatitjen e tyre nga Kola e prita me mjaftë interes. Kjo edhe për faktin se, për shumë probleme që bënin fjalë dhe përkonin me kohën kur unë kisha dalë në jetë dhe në punë. Nuk ishte e lehtë për mua që ta merrja përsipër këtë detyrë në lidhje me këtë libër. Isha nën një farë trusnie shoqërore dhe psikologjike. Zotin Kolë e kisha pasur mësues, kishim krijuar marrëdhënie mjaftë të mira, vazhdonin dhe vazhdojnë edhe aktualisht. Nga ana tjetër më duhej të respektoja mendimet e tij të prera dhe të vendosura, për kohë dhe veprime në kohë të ndryshme, por edhe të bëja ndonjë ndërhyrje pa dëmtuar idenë. Kolë Funiçi asnjëherë nuk ka manifestuar ndjenjën ndaj të tjerëve, si "këtë e kam pasur nxënës", "këtë e kam çuar në shkollë", "këtë e kam futur në punë", siç mund të shfaqet jo radhë te ndonjë tjetër, dhe ti trajtoj njerëzit si të varur prej tij, të kërkojnë prej tyre të bëjnë siç thotë vetëm ai apo ndonjë qëndrim si këto.

Në faqet e këtij libri, mund të thuhet pa frikë, së lëxuesi do të shikojë një Kolë ashtu siç ishte, i vendosur për realizimin e detyrave të kohës, më vështirësitë e pengesat objektive dhe artificiale, kri-

tik për punën, pavarësisht se kë kishte përpara. Kolë Funiçi vlerësonte arritjet, pavarësisht se kush drejtonte, por analizonte deri në hollësi edhe shkaqet e mosrealizimeve, personave përgjegjës, e të tjera. Kjo ka qenë dhe është një veçori, por, mjaft e rëndësishme, e zotit Kolë.

Zoti Kolë shpreh hapur pikpamjet e tij për të gjitha kohët që ai ka punuar dhe kaluar, për të kaluarën dhe të sotmen, dhe jep arsytimin e ngjarjeve dhe fenomeneve për të gjitha. Qëndrimi kritik i Kolë Funiçit është kuptimplotë, i arsytuar në mënyrën e tij, i thellë në pikpamjen shoqërore dhe filozofike.

Në faqet e këtij libri gjejmë një Kolë shumë aktiv, të papërtuar, dhe vërtetë ashtu ishte, në realizimin e detyrave të ngarkuara, gjendët sa në një fshat, sa në një tjetër, sa te analizat për problemet e arsimit dhe në ato të shëndetësisë. Por duhet thënë se në punën e tij ka pasur gjithnjë rezultate. Zoti Kolë, në asnjë rast në këtë libër, por as në jetën

në fillimet e proceseve demokratike. Ai mendon se nuk duheshin shkatrrue, por mund të shfrytëzoheshin deri sa të mund të zëvendësoheshin me teknologji bashkëkohore. Kolë Funiçi është kundër gjuhës së ashpër madje të fliqur që dëgjohet dhe përdoret veçanërisht në parlamentin tonë, e në mes liderve të nivelit të lartë, sepse kur luajnë një vesh atje lart, këndej poshtë mund të bier tërmet. Parlamenti dhe lidertë duhet të jenë modeli për kulturë e thellësi mendimi për të gjithë dëgjuesit. Në shumë raste, veçanërisht ato seanca që transmetohen direkt, janë një model vetëm për rrugën dhe rrugaçët. Të gjitha këto në një formë apo një tjetër i trajton zoti Kolë në rreshtat e këtyre kujtimeve dhe mendimeve.

Në faqet e këtij libri zoti Kolë tregon një kujdes shumë të madhe për familjen e tij, bashkëshorten Linë, fëmijët, nuset, dhëndrrat, fëmijët e tyre, i këshillon për të ardhmen dhe kujdesin që duhet treguar për ecjen e tyre përpara. Nuk ndalët vetëm në rrethin e ngushtë, por hell shikimin te të gjithë të afërmit, shokët, miqtë, kumbarët, dashamirët. Hapur, qetësisht dhe plot sinqeritet, u bën të qartë fëmijëve dhe të afërmeve të tij, që të jenë të qetë dhe të sigurtë se në të gjithë veprimtarinë e tij, që nga fëmijëria e deri tash që është 80 vjeçarë, nuk ka asnjë "kleçkë në biografinë" për bëma negative të qëllimshme e të rëndësishme, dhe përveç fjalëve të mira nuk do të dëgjojnë asgjë tjetër.

Në faqet e këtyre kujtimeve gjejmë se Kola Funiçi ishte një njeri me pikëpyetje për organet e ashtuquajtura të mbrojtjes së diktaturës së proletarietit, për 15 vjet, por megjithë "kujdesin" e tyre nuk arritën ta dërgonin prapa hekurave, sepse ishte dhe është i pastër si qelibari, se nuk e lanë për sytë e tij të bukur.

Kolë Funiçi, ishte një njeri që besonte në përparimin dhe zhvillimin e vendit në atë kohë, dhe përpiquej për forcimin e tij, por gjithmonë në bazë të ligjeve e udhëzimeve të kohës, dhe të moralit shoqëror, hapur dhe pa prapaska. Zoti Kolë përpiquej për të larguar këdo nga veprimtaria e keqja dhe nga rreziku për tu përbadhur me ligjin. Kjo veprimtaria e Kolës është për tu vlerësuar, por është edhe shumë e moralshme.

Është e vërtetë se këto kujtime ju drejtohen së pari, familjës dhe të afërmeve të autorit, shokëve dhe miqëve, por në faqet e tij mund të gjejnë veten shumë e shumë persona të të gjitha niveleve. Këtu çdo kush që i lexon shikon një Kolë Funiçi të vërtetë. Ai nuk fshihet pas gishtit, nuk bën modelin e strucit, por është i sinqertë, i hapur.

Kola, duke parë rënjen e ekonomisë, mendon se ndryshimet që u bënë në fund të viteve '80 ishin si

një kërkim i një rruge ndryshe, për të mëkëmbur ekonominë, për më shumë zhvillim dhe përparim, për më shumë liri fjale dhe lëvizjeje, por kurrsesi nuk i quan të drejta mohimin e arritjeve në kohën e kaluar në arsim, kulturë, shkencë, por edhe në shumë degë të ekonomisë qofshin këto bujqësore dhe industriale. Nuk miraton shkatërrimet që u bënë

në fillimet e proceseve demokratike. Ai mendon se nuk duheshin shkatrrue, por mund të shfrytëzoheshin deri sa të mund të zëvendësoheshin me teknologji bashkëkohore. Kolë Funiçi është kundër gjuhës së ashpër madje të fliqur që dëgjohet dhe përdoret veçanërisht në parlamentin tonë, e në mes liderve të nivelit të lartë, sepse kur luajnë një vesh atje lart, këndej poshtë mund të bier tërmet. Parlamenti dhe lidertë duhet të jenë modeli për kulturë e thellësi mendimi për të gjithë dëgjuesit. Në shumë raste, veçanërisht ato seanca që transmetohen direkt, janë një model vetëm për rrugën dhe rrugaçët. Të gjitha këto në një formë apo një tjetër i trajton zoti Kolë në rreshtat e këtyre kujtimeve dhe mendimeve.

Në faqet e këtij libri zoti Kolë tregon një kujdes shumë të madhe për familjen e tij, bashkëshorten Linë, fëmijët, nuset, dhëndrrat, fëmijët e tyre, i këshillon për të ardhmen dhe kujdesin që duhet treguar për ecjen e tyre përpara. Nuk ndalët vetëm në rrethin e ngushtë, por hell shikimin te të gjithë të afërmit, shokët, miqtë, kumbarët, dashamirët. Hapur, qetësisht dhe plot sinqeritet, u bën të qartë fëmijëve dhe të afërmeve të tij, që të jenë të qetë dhe të sigurtë se në të gjithë veprimtarinë e tij, që nga fëmijëria e deri tash që është 80 vjeçarë, nuk ka asnjë "kleçkë në biografinë" për bëma negative të qëllimshme e të rëndësishme, dhe përveç fjalëve të mira nuk do të dëgjojnë asgjë tjetër.

Si gjithë banorët e këtyre maleve, edhe familja e Kolë Funiçit, pati vështirësi ekonomike të mëdha, të cilat pasqyrohen mjaftë hollësisht në faqet e këtij libri. Për Kolën, motrat dhe vëllezërit e tij, pati ngakesa më të mëdha. Mbeten jetim të vegjël, pasi u vdes baba. Vëshirësi të shumta kaluan këta fëmijë dhe nëna e tyre. Gjithsesi u rritën dhe gjithnjë erdhën në ngritje ekonomike dhe shoqërore.

Një vend të respektuar dhe shumë të rëndësishëm në këto kujtime zë vendlindja. Kaprreja me "një hektar" qiell, është për Kolë Funiçin një oaz i vërtetë për nga vlerësimi e dashuria për të. Por, jo, më pak don Gimajt, Shalën, Dukagjinin, dhe siç shkruan ai diku në këtë libër, duke dashur familjen, fshatin krahinën, zonën, kështu dhe vetëm kështu don edhe gjithë vendin, Shqipërinë.

E gjithë sa shkruhet në këtë libër, është një farë amaneti (testamenti) për familjen dhe të afërmit e tij. Por, është edhe si metodike, një mundësi që gjithsecili mund të përpiquej të bëjnë një gjë të tillë, sepse brezi i ri dhe ata që vinë kanë shumë nevojë për to, sa do që sot duken të parëndësishme, por sa më shumë vite të kalojnë bëhen më të nevojshme, madje të domosdoshme, kanë më shumë vlera.

Të lumtë dora dhe mendja Kolë Funiçi! Me shumë respekt, ish nxënësi, kolegu dhe shoku Juajt i përhershëm.

Luigj SHYTI
Shtator, 2017



RROK MARTIN LOGU - Inxhinier dhe Diplomat

U nda nga jeta në muajin Gusht 2017

Rroku kishte një histori familjare të lavdishme në zonën e Dukagjinit. Gjyshi i tij, Ded Sokol Logu ishte i njohur për patriotizëm, mençuri dhe bujari. Ndërsa gjyshja, Drande Ded Logu ishte e bija e Ded Lulashit nga Lotaj – Shalë, bashkëluftëtar me Mehmet Shpendin, Çun Nikën e Marash Delinë.

Prindërit e Rrokut, babai Martin Ded Logu e nëna Cubë Qerim Logu, gëzonin respekt të veçantë si prindër shembullorë. Axha i tij, Mëhill Ded Logu është ndër mësuesit e parë dukagjinasi.

Rroku, djali i tyre, lindi, u rrit dhe mori edukatën e parë në këtë mjedis familjar të nderuar në Lekaj e më gjerë.

Kush ishte Rrok Logu?

U lind në fshatin Lekaj, Shalë në vitin 1962. Është martuar me Bora Logun dhe ka lënë pas dy fëmijë, Martini dhe Antonia. Dy vite të shkollës fillore i ka mbaruar në vendlindjen e tij. Për arsye familjare, por edhe të kërkesave që kishte koha, familja u transferua në Hidrocentralin e Fierzës. Aty Rroku përfundoi shkollën 8 vjeçare me rezultatet të shkëlqyera. Nuk ju mundësua një e drejtë studimi për shkollën e mesme dhe kështu filloi shkollën profesionale, dega elektrike në Fierzë (pa shkëputje nga puna). Pas saj, mbaroi dhe shkollën e mesme duke merituar Medaljen e Artë. Më 1982, ndërsa familja transferohet në Shkodër, Rroku fillon Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në Universitetin e Tiranës dhe diplomohet në vitin 1987. Edhe gjatë studimeve universitare, Rroku u dallua për përkushtimin dhe rezultatet e larta që arriti.

Pas përfundimit të studimeve të larta,

emërohet inxhinier elektrik në Hidrocentralin e Komanit. Kjo ishte një vepër madhore e hidroenergjitikës në vend, çka



i krijoi mundësinë Rrokut, jo vetëm të aftësohej më tej në detyrat e profesionit, por edhe të dilnin në pah aftësitë dhe cilësitë e tij në punë. Krahas detyrës, vijon punën kërkimore – shkencore në fushën e optimizimeve të rëndësishme në sistemin energjitic në bashkëpunim me Katedrën e Çentraleve Elektrike dhe DSHSE. Më 1992 emërohet në pozicionin e Kryeinxhinierit në NISH Elektrikun e Shkodrës.

Megjithëse në ato vite ishte një periudhë e trazirave të mëdha, ku dëmtimet, mospagesat dhe elementë të tjerë e dëmtuan mjaft sektorin, Rroku diti të jetë një profesionist i vërtetë. Gjatë punës së tij karakterizohej nga një ndjenjë e lartë përgjegjësie për detyrën dhe aftësitë shkencore në specialitetin e tij. Më 1994 ai tërhoqet në aktivitet privat.

Me 1998, së bashku me familjen trans-

ferohet në Tiranë, ku vijon bashkëpunimet për projekte inxhinierike me Karitasin Shqiptar, atë italian dhe zviceran. Në të njëjtën kohë fillon mësimdhënien pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike në Universitetin Politeknik të Tiranës, në lëndën automatike e sistemeve energjitike deri në vitin 2006, vit që transferohet në Romë.

Në vitin 2004 emërohet Anëtar i Komitetit Shtetëror për Kultet. Në vitin 2006, emërohet Ambasador i Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë dhe i Shqipërisë pranë “Urdhërit Sovran” të Maltës, i pari ambasador i vendit tonë pranë këtij Urdhëri. Gjatë mandatit të tij të gjatë, marrëdhëniet diplomatike dypalëshe me vendet përkatëse, njohën zhvillime pozitive të rëndësishme.

Në vitin 2013 përfundon misionin diplomatik në Romë dhe së bashku me familjen kthehet në Tiranë, ku rimerr impenjimet e mëparshme akademike pranë Universitetit Politeknik dhe ato administrative pranë Komitetit Shtetëror të Kulteve.

“Urdhëri Sovran” i Maltës e emëron diplomat në rangun e ministrit në Ambasadën e këtij Urdhëri në Tiranë.

Zoti Rrok Logu ka mbajtur tituj dhe çmime të rëndësishme ndërkombëtare si “Kavalier i Urdhërit Piamo të Piut IX” të klasit të Parë; “Kavalier i Kryqit të Madh” për merita Militense; Çmimi ndërkombëtar “Domenico Aliquo”; Çmimi Ndërkombëtar “Foyer des Artistes”; Çmimi Ndërkombëtar “Bonifacio VIII”.

Shoqata e Miqësisë dhe Bashkëpunimit Shqipëri – Itali, në datën 24 Shtator 2017 i dha zotit Rrok Logu (pas ndekjes)

titullin “Ndëri i Shoqatës së Miqësisë dhe bashkëpunimit Shqipëri – Itali”

Rrok Martin Logu u nda nga jeta në Gusht të 2017-tës pas një sëmundjeje të rëndë. U përcoll për në banesën e fundit nga qindra bashkëqytetarë nga Shkodra e më gjerë. Kishin ardhur nga Italia disa priftërinj. Mesazhi i dërguar nga Papa Françesku nga Selia e Shenjtë në Romë, ishte kuptimplotë për vlerat që kishte Rrok Logu dhe për mbresat pozitive që ai la pas.

Në mesazhin e Papa Françeskut thuhet:

“Fort të nderuarit arqipshkvit të Shkodër- Pult, Angelo Massafra.

Pikëllohem për vdekjen e parakohshme të Shkëlqësisë së Ti, Rrok Logu.

Shenjtëria e Tij Papa Françesku, i përcjell ngushëllimet më të përzemërta gruas Bora dhe fëmijëve të Ambasadorit. Jam i ndërgjegjshëm për punën e tij dedikuese me promovimin dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë. Shenjtëria e Tij lavdëron shpirtin e mëshirshëm të Ambasadorit për dashurinë ndaj të Madhërishmit Zot. Të gjithë atyre që vajtojnë për të deri në shpresën e vërtetë të ringjalljes, Papa Françesku u dërgon përzemërsisht Bekimet Apostullore, si një premim i paqes dhe ngushëllimit në Zotin Jezus”.

I përjetshëm kujtimi i inxhinierit Rrok Martin Logu!

Martin Çetina

HALLOWEEN OSE SHQIPTARËT BRENDA KOHËS MODERNE DHE PËRENDIMIT!

Besi BEKTESHI

Çfarë mrekullie, festa e re dhe e bukur e shqiptarëve me 31 tetor! Halloween-i është festa, e cila mbas “Shën Valentinit”, ka mbushur zemrat e tyre dhe ka kthyer me 14 shkurtin dhe 31 tetorin klubet plot dhe rritur fansat që sigurisht gëzojnë! Pak kush të shpjegon si për Shën Valentinin dhe akoma më shumë (për pak them si dijeni) nuk dinë për Halloween-in! Mor nuk dinë ndonjë gjë as për priftin në histori dhe dy rinushat për 14 shkurtin, dhe as për origjinën celtike të 31 tetorit dhe si ardhje romane, por kthyer në model botëror nga amerikanët për “kungullin me dritë brenda” që shëmbëllen horror, por në fakt nuk është! Por ja që “Halloween” është tashmë një festë e jona! Nuk më vjen keq aspak! Sa më tepër momente festimi, kujtimi apo demonstrimi të adoptojmë nga perëndimi, nga Evropa, nga vendet e qytetëruara – aq më mirë është për ne! Absolutisht dakord dhe për festa të tjera si

bie fjala “dita e babait” apo “dita e nënës”, sipas perëndimit dhe shumë e shumë ditë të tjera! Të fillosh të përvetësosh ditë të perëndimit – do të thotë se po afroresh me të. Po kthehesh më fytyrë nga perëndimi! Sepse, sigurisht jemi vend që kemi shumë lidhje me lindjen, orientin, zakonet dhe sigurisht modellet festuese të tij! Kthimi qoftë dhe kështu për modë - aspak nuk bën keq te ne!

Po ku e kam problemin, çfarë dua të them?! Dua të them, se shoqëria jonë sërish është artificiale, sipërfaqësore dhe deklamuese! Mungon thelbi sërish! Është ajo që kuptohet kur shikon celularin e fundit, makinën e fundit të një shqiptar – dhe po te ai shqiptar, janë taksat e papaguara ose të papaguara për t’i bërë bisht! Kur shikon një shtëpi trekatëshe madhështore, që njerëzit e saj, pronarët shqiptar, të cilët krenohen se e kanë më të bukur se pronari i tyre në Itali – nuk është paguar energjia, uji dhe është pa leje oborri i rrethuar! Po po, makinë mijëra euroshe të cilës “nuk i bëhet shërbim prej muajsh” se i duken shumë lekët te mekaniku!

“Halloween” është festa e re e shqiptarëve që i afron me perëndimin, i sjellë në kohë, në të njëjtën kohë me perëndimin – e sigurisht me vetëm Halloween-in mjaftohen për të deklaruar evropianizimin e tyre! Po sigurisht dhe kur të vijë Shën Valentini - edhe

me atë festë të përhapur hareshëm në Shqipëri e shoqërinë shqiptare! Duket gati - gati – sa jemi për t’u pranuar në BE se festojmë “Halloween-in”! Duket sikur jemi pjesë e BE-së, vetëm për këtë fakt, këtë festim dhe këtë afërsi me pikërisht botën perëndimore! E bëjmë me shumicë e përmendim me shumicë dhe është pikërisht “Halloween-i që na bën Evropianë”, na afron me Evropën në sjell në kohë moderne pikërisht me perëndimin!

Ndërkohë vazhdojmë të hedhim plehrat jashtë kazanit, të mos respektojmë vizat dhe semaforë, të mos zbatojmë ligje dhe të mos jemi njerëz të së thënës – faleminderit, ju lutem, më fal! Me Halloween-in ne mbylлим dhe mos dijenitë tona mbi demokracinë. Mos zbatimin e saj kudo! Kemi Halloween-in dhe nuk kemi nevojë për rregull dhe disiplinë në punë dhe administrim – si në Evropë! Jemi modern se festojmë Halloween-in dhe pastaj nuk ka problem se një zyrtar në drejtësi merr lek për të dhënë drejtësi! Mjafton të festojmë Halloween-in dhe nuk ka kurrfarë problemi se “korrupsioni është qelizor dhe një manjakëri shqiptare, për nga forma dhe modeli”!

Me Halloween-in jemi në kohë moderne dhe perëndim – sepse nuk na duhet asgjë mbi raportin që kemi me urbanen dhe lirinë e prishur të tjetrit, në saj të përfitimit tonë në kurriz të tij! Sigurisht mjafton modernizmi me

Halloween!

Duket sikur kjo dita e re (Halloween-i) moderne, na justifikon të gjitha pas mbetjet tona në kohë. Sikur na “shëron” të gjitha plagët që i kemi hapur vetes me marrëzitë tona të për-bashkëta kundër qytetërit – së paku këto 27 vitet e fundit! Po pra, nuk po përmend diktaturën, se ajo “horrorin” nuk e kishte me shaka dhe kungullin e kishte të qartë se me çfarë do ta zëvendësonte në ideologji!

Gjithsesi tashmë kemi dhe Halloween-in dhe padyshim që mirë është! Por, nuk është se nuk e dimë që “kungulli” i Halloween-it, nuk na çon qartësisht në Evropë! Këtë e dinë të gjithë! Ai sigurisht jo! Aty na çojnë “kungujt” tanë, kur vërtetë ti përdorim realisht për të shkuar seriozisht dhe sinqerisht aty ku kemi bërë një zotim! E ky zotim është bërë pa pasur parasysh kungullin e Halloween-it, por brendësinë e kungullit (kokës) tonë!

Padyshim që do të festohen dhe padyshim që kalojnë mirë të gjithë kur festohet! Por për të qenë në kohë moderne dhe afër perëndimit, duhet të jemi realistë dhe të qartë mbi rëndësinë e përmbajtjes dhe sigurisht më pas dhe të formës. Megjithatë dhe Halloween-i shërben për diçka. Ai mundohet të sqarojë se – jemi si shoqëri, rrugës vendit që aspirojmë! E mbase kjo është më e mira që na dhuron Halloween-i!

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi*** poezi *** poezi*** poezi *** poezi



**POETJA SADETE METAJ, NGA ISTOGU,
ME BANIM NË NORVEGJI**

Diçka pikon

Diçka pikon
Çdo ditë në shpirtin tim
Je ti që më kërkon,
Je ti kënga që çel çdo agim,
Ëndrra ime në qiell vërtitësh si tufan,
Mallëngjimi im det me trazime.
Diçka pikon dhe mbushet një oqean
Ti dashuria ime plagët m'i shëron,
Me mallin e çdo stine të gjethëruar.
Ti je gjëmimi që gjëmon,
Diçka që pikon është kënga e pambaruar,
Dhe poezia që vërtitët në mendje ende e pa shkruar ...

Të kërkoj

Qiellit të kaltër kalërova.
Mes yjesh, hëna ndriçonte.
Kudo si e marre vrapoja.
Natën zemra të kërkonte.

Pak e njihja atë bote.
S'lashë rrugë s' vend.
Pa ty çdo gjë më dukej e kote.
Zemër plasur natës, ec e rend.

Dikur të gjeta një dite.
Në skaj të botës larg.
Në shpirt me dhe drite.
Në jetë një portë u hap.

Me duaj, zemër e çiltër, si lulen

Po më dhuron një lule?
Sytë e mi t'i shijojnë ngjyrat ...
Më dhuro një buzëqeshje,
Të na ndrisin fytyrat ...

Me përkëdhel butësisht,
Pranvera ime, Dielli im.
Dua të emocionoj shpirtin.
Të jetoj e të lumturohem,
Në puthjet, pa mbarim..

Më duaj, zemër e çiltër,
Dhuromë shumë dashuri ...

Kur të iku nga kjo bote
Mos me qaj si fëmije.

Unë edhe ne të përtejmen jete
Do të sjelle ndërmend ditët,
Që më ke dashur ...

Në ketë shndritje tënde të florinjte

Sonte, një mbrëmje
kaq e bukur me hënë ...
Ma hënëzoi shpirtin tim...

Oj, e bukura hënë,
pashe e ndjeva dritën tënde ...
Pashe sytë e mi
të presin agun e dashurisë, të larguar ...
Mu për shfaq, sikur Ai, rrinte pas "reve"
Sikur gjithçkaje times i vinte perde..

Më shndrisje, si flori lotët e mi,
teksa pikonin nga sytë e malluar ...
Å mund, o hënë, unë, një e dashuruar,
Të verbohem nga "terri" i atij që dua.
Në ketë shndritje tënden të florinjte?

Përkëdhelje valësh shpirti

Ti je frymëzimi im,
Filladi i freskët përcjellës
I fëshfërimës së valëzave të detit,
Duke e kthyer në simfoninë më të bukur,
Edhe më madhështore se bet' hovicane e vivalde ...
Simfonia që shëron zemrën time
dashuruar marrëzisht me zemrën tënde...

Vështrim tretur horizontit ...
Në ekranin e syve të mi,
pulëbardha vrapon krahëhapur,
ngre stërkala uji ...
Çuditërisht,
më ngajnë me buzëqeshjet e tua!....
Vetiu hap krahët,
ndjej përqaftimin tënd diellor...

Mbi ndërtimin tim anatomik,
filladi i freskët ledhatar më përkëdhel
me ngrohtësi shpirti ...

Rrezet më ngrohin buzët ...
Duke më nisur puthjet të valet ...

Shtatë Diej

Kur fle
Të ëndërroje Ty,
dhe atëherë,
të ponoramoj përsëri.

Eh sikur të dyve,
Shpirt ëndrra
të na sendëzohej,
valle a mund, të përfytyrohej
çfarë do të ndodhte?
çfarë do të ndodhte?!

Qaj për ta
kur çdo gjë
s' dashuron me,


fjetja e rënde,
pa gjallim fle..

Puhia dashurore
nga bregu lindore
Hapësirën time e përdhel.
Mbi qiellin tim, o njerëz
Shtatë Diej....

E pafjetur...

Dielli ndriçon mbi ujërat e kulluar,
Sajon mbi valë pika të shkëlqyera...
Shkëlqen, pors i yll, mbi ujërat e shaluar,
Mbi ujëra që zbret,
kjo drite e pashuar...
Atje të presin skutat e kujtimeve,
rruga e mbuluar me natë...
Megjithatë, ti eja në atdhe...
Eja, ti hënë, vështro botën
që nuk flenë...
Merr ndriçim nga ky peizazh...

Kam kaluar shumë pranvera,
Malli, kurrë, për ty nuk u shua.



Gazeta e numrit të kaluar, me numër 168,
u mundësua gjithashtu nga z. Gjergj Leqeja

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh **Kimay**
PRODUCTION Produzione Giacche

